

KONGRESET
BESA dhe
ASH të sigurt
në koalicion

Fq.3



**AVOKATI I
POPULLIT**
Kontroll
qytetar për
punën e policisë

Fq.5




Edhe me
bujqësi
mund të
jetohet

Fq.8



Koha

www.koha.mk



Koha për
enigmë

Fq.11-14

AKTUALE

Nën ilupë
abuzimet me
projektet e
parealizuara



Ndërsa në Ministrinë e Kulturës shqyrtimit i projekteve për Programin nacional të kulturës është në proces, po ashtu janë nën monitorim edhe projektet e viteve të kaluara, të cilat nuk janë realizuar. Nga ky institucion nuk japin shifra të sakta lidhur me abuzimet me fondet...

Fq.6

REORTAZH

18 vitet e
humbura
të Trepçës

Fq.15

RAJON

Hiqni dorë
nga shfuqizimi
i Speciales

Fq.16

GLOBI

Çfarë duan
demonstruesit
e Iranit?

Fq.17



STOLTENBERG NË SHKUP, BISEDIME PËR EMRIN NË NJU-JORK

EMRI, AMERIKANËT NISIN PRESIONET



Vizita e Stoltenbergut më 17 dhe 18 janar, në Athinë sikurse në Shkup, por edhe në mediat ndërkombëtare vlerësohet si intensifikim të aktiviteteve për zgjidhjen e problemit me kontestimin grek të emrit të Maqedonisë, ndërsa përmendet edhe presioni që SHBA-të po i bëjnë Greqisë

Fq.4

Nga 525 libra, 16 me firmën e autorëve shqiptarë

Shkup, 5 janar - Ndryshimi i paralajmëruar i programeve mësimore, respektivisht teksteve shkollore veçmë ka filluar. Nga Shërbimi Pedagogjik i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës (MASH) njoftohen të gjithë botuesit se ka përfunduar hartimin i programeve të reja mësimore nga lëndët e gjuhëve të huaja për vitet e katërta të arsimit të mesëm. Pra, botuesit nga vendi dhe të huaj, mund të konkurrojnë për

botimin e librave a atyre librave, që sipas të gjitha gjasave, do të jenë gati për vitin e ardhshëm shkollor 2018/2019, pasi Programet mbi bazën e të cilave duhet të punohen librat përkatës - veçmë janë miratuar nga MASH-i. Bëhet fjalë për libra të shkollave të mesme, të cilat përdoren në drejtimin gjimnaz apo drejtimet të mesme profesionale katërvjeçare. Ajo që bie në sy, në fondin e...

Fq.6



LAJMI I FUNDIT

MARRËVESHJA ME BULLGARINË RATIFIKOHET MË 15 JANAR

Shkup, 5 janar - Propozim-ligji për ratifikimin e Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Bullgarisë do të jetë në rend dite të mbledhjes së 30-të të Kuvendit, të caktuar për më 15 janar. Propozimi nga fundi i muajit të kaluar kaloi në Komisionin për politikë të jashtme. Marrëveshja, siç kumtoi MIA, u nënshkrua më 1 gusht 2017 nga ana e kryeministrave të të dy vendeve, Zoran Zaev dhe Bojko Borisov, për shkak të përforsimit të marrëdhënieve të ndërsjella miqësore, avancimit të fqinjësisë së mirë, zhvillimit të marrëdhënieve të ndërsjella të gjithanshme, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare. Kjo është rezultat i procesit negociuesi pesëvjeçar të grupeve të punës të të dy MPJ-ve dhe paraqet sendërtim të marrëveshjes së nënshkruar në vitin 1990. Zëvendëskryeminstria bullgare për reforma në jurisprudencë dhe ministre e Punëve të Jashtme, Ekaterina Zaharieva, nga fundi i muajit të kaluar në intervistë për Radion nacionale bullgare (BNR) paralajmëroi se Marrëveshja do të ratifikohet në Kuvendin popullor në janar. "Marrëveshja për fqinjësi të mirë me Maqedoninë është dërguar nga Qeveria në Kuvend, nuk është ratifikuar ende, por shpresoj se në janar të zgjedhurit e popullit do ta mbështesin. Më me rëndësi është se edhe para se të ratifikohet marrëveshja, d.m.th. të hyjë në fuqi, ajo po përmbushet. Madje edhe po të ishte ratifikuar, nëse marrëdhëniet tona vazhduan të rrjedhin në mënyrë të njëjtë, që nga ajo se kemi nënshkruar Marrëveshje për miqësi dhe fqinjësi të mirë", deklaroi Zaharieva. Më 15 janar zyrtarisht do të prezantohet edhe kryesimi i Bullgarisë me BE-në.

MIRATOHET EKSTRADIMI I GRUJEVSKIT DHE BOSHKOVSKIT

Selanik, 5 janar - Këshilli i gjykatësve në Selanik vendosi që Nikola Boshkovski dhe Goran Grujevski të ekstradohen në Maqedoni. Sipas portalit Voria nga Selaniku, njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, menjëherë pas publikimit të aktgjykimit, dy të akuzuarit, kanë parashtruar ankesë kundër vendimit të gjykatës, që rastin ta shqyrtojë Gjykata supreme në Athinë. Edhe publikimi i vendimit, si dhe dëgjimi, ishin pas dyerve të mbyllura. Seanca e fundit u mbajt më 22 dhjetor dhe u caktua që të kumtohet vendimi i Këshillit të gjykatësve. Me ndërprerje të vogla, gjykimi ka zgjatur më shumë se dy orë, pasi janë bërë tentime që të gjendet përkthyes. Përkthim nga gjuha greke në maqedonase nuk u pranua nga mbrojtja, dhe për shkak të pamundësisë që të gjendet përkthyes në maqedonisht, seanca u caktua për dy javë më vonë. Përveç për ekstradim, Grujevski dhe Boshkovski kanë edhe dy procese të tjera në Greqi, që nuk lidhen njëri me tjetrin. Njëri është për pasaporta të falsifikuara, me të cilat janë kapur në aeroportin e Selanikut, për të cilin gjykimi, pas tre anulimeve, do të mbahet më 17 maj të vitit të ardhshëm. Rasti tjetër është pas kërkesës së parashtruar për azil më 29 nëntor, proces që mundet në mënyrë shtesë ta ngadalësojë vendimin eventual pozitiv për ekstradim në Maqedoni.

JAP DORËHEQJE NGA NËNKRYETARI I BESËS

"Në vigjilje të mbajtjes së mbledhjes së rregullt të Këshillit Qendror të Lëvizjes BESA, ndërsa "në frymë të konstruktivitetit, vetëmohimit dhe gatishmërisë për zhbllokimin e organeve të Lëvizjes dhe për rihapjen e procesit për zgjedhje të brendshme, deklaroi se nga dita e sotme (5 janar 2017) jap dorëheqje të përvokueshme nga detyra 'nënkryetar i Lëvizjes BESA'. Ndonëse rezultati zgjedhor në zgjedhjet lokale në Komunën e Çairit ishte në shenjë të rritjes së numrit të votave të BESËS dhe ndonëse përballë kishim LSDM-në me vagonin e saj të ndryshkur (BDI), pra pushtetin dhe parapushtetin, policinë dhe parapolicinë, kishim vagabondët dhe gjithë shpurën e kriminelëve, si dhe sabotuesit e brendshëm - tashmë të njohur për opinionin, ne arritëm rezultat solid, që ishte dëshpërues për gjithë sojin e sipërpërmendur dhe mirënjohje për të gjithë njerëzit vullnetmirë të Çairit, veçmas për rininë që shfaqti sakrificën më të madhe për përmbytjen e një regjimi që e ka kapur keq dhe rëndë jetën e qytetarëve tanë. Megjithatë, gjendja faktike është e tillë që ata, duke e vjedhur votën e lirë, sot vazhdojnë të (keq)qeverisin me Komunën e Çairit. Prandaj, duke e njohur këtë rezultat - sido të arritur, në shenjë të respektimit të vlerave të vendosura nga Lëvizja BESA, që "të merret përgjegjësia politike për rezultatet", po jap dorëheqje, duke dhënë mesazhin se askush në BESË nuk është më i rëndësishëm se BESA dhe askush në BESË nuk është i pazvëndësueshëm. Me këtë rast deklaroi se, mbetem jashtë edhe nga gara për kryetar të Lëvizjes BESA në Kongresin e Parë të Lëvizjes...", shkruan Zeqirija Ibrahimimi në FB.

RAMUSHI MERAKLI DHE ENTUZIAST NË BUDALLALLËK

"Deri para luftës u 'zavit' me gajbe të birrave nëpër sokaqe t'katunit, e sot i erdh dita, pa punu kurrë një punë të vetme në jetën e tij me pushu në vendin më të shtrenjtë në botë. S'sheh kund kesi yrrneku, me qenë njeriu si Ramushi merakli dhe entuziast në budallallëk. As që mundohet m'i mbajt fshehtë punët e kqija që ia marrin fytyrën dhe e bëjnë neveritës, por shkon e i sforcon ato të meta që me ra në sy prej helikopteri...taman abnormal, s'la njeri pa e kthy kundër vetes... s'sheh kështu.. I shet kurum popullit të varfër, as nuk ja rrok truni se rinia janë të mërzhitur si pleqtë, pa pare e pa rrugëdalje; s'ja rrok, s'e din e as ndoshta s'i tregojnë sa shumë po e shajnë gjinja, sa shumë po e nëmin e po e mallkojnë, i madh e i vogël, gra e burra po ia dëshirojnë të gjitha të këqijat që ekzistojnë. S'ka njeri që s'thotë 'mos ia paft hajrin rrogës'. P.S. Ramushi po sillet si njeriu që e di se i ka ditët e numëruara; Si njeriu që e di se nuk i shkon larg; Si 'i pamendi' që e jeton çdo ditë sikur të ishte dita e fundit e jetës së tij; Si ateisti që nuk beson në 'ditën e gjykimit'. Si i çmenduri që nuk pranon të dalë nga senatoriumi sepse brenda tij mund ta konsiderojë veten 'zot' dhe s'ia prishë kush disponimin. PDK po e shfrytëzon padijen dhe pasionet e sëmura të Ramushit me kallë Kosovën si Neroni-Romën, në kohën kur opozita s'është kërkaq hiç. Unë (e them me sinqeritetin më të madh), besoj (si Montesquieu) se luksi dhe padija e Ramushit po e shkatërojnë në themel Republikën", shkruan publicistja kosovare Kimete Berisha.

MEDIA Citate

Ndërkohë që Shqipëria është në fazën vendimtare të instalimit të institucioneve të reja të Reformës në Drejtësi, mbetet të shihet nëse ky proces do të sjellë ndëshkimin e korrupsionit politik në nivele të larta. Eksperti i antikorrupsionit Milan Antonijević shprehet se ndëshkueshmëria e politikanëve është qëllimi final i Vettingut. Milan Antonijević, Ekspert i antikorrupsionit: "Politikanët duhet të jenë më të shqetësuarit nga zhvillimet e fundit në procesin e Vettingut. Ky mund t'i çojë ata përpara një procesi të mundshëm gjyqësor të paanshëm që ka ndodhur në shtetet e rajonit. Ndjej qe ka një pritshmëri të madhe nga publiku jo vetëm ata që punojnë si unë në sistemin e drejtësisë".

(TV Klan, 5 janar)

Ekonomia edhe gjatë vitit që shkoi vazhdoi të ë këtë probleme të mëdha. Qeveria as këtë vit nuk arriti t'i realizojë projektet madhore. Brezovica nuk u koncesionua, "Kosova e Re", përkundër arritjes së marrëveshjes në fund të vitit me kompaninë amerikane "Contur Global", nuk filloi të ndërtohet. Telekomit e Posta e morën teposhtëzen. Ndërmarrjet strategjike sikur që është Trepça nuk nisi të funksionojë me ligjin e ri, ku Qeveria nuk arriti ta emërojë bordin në mënyrë që të fillojnë proceset. Gjitha këto projekte që konsiderohen të dështuara gjatë vitit 2017 ka gjasa që sipas autoriteteve të realizohen gjatë këtij viti.

(Koha Ditore, 5 janar)

Siç ndodh shpesh në Iran edhe protesta e tanishme zhvillohet në disa nivele: brenda Iranit fillimisht drejtpërdrejtë në rrugë - dhe aty ka pasur ndërkohë edhe demonstrata masive pro regjimit - por edhe në luftën për pushtet midis qendrave të ndryshme të pushtetit të establishmentit politik. Jashtë Iranit zhvillohen diskutime për përgjigjen e duhur ndaj këtyre zhvillimeve. Kjo lidhet me shqetësimin se mos përmes reagimeve nga jashtë forcohen pa dashje përfaqësuesit e vijës së ashpër në Teheran dhe dobësohen forcat e moderuara.


(DW, 5 janar)

NËSE NUK E KENI DITUR...

A KA PASUR QYTET ME EMRIN DODONË?

Dodona ka qenë qytet dhe qendër e rëndësishme kulturi në Epirin antik, 18 km në jugperëndim të Janinës. Rrënojat janë rrëzë malit Tomaros. Dodona u shkatërrua përfundimisht gjatë luftës gotike në kohën e Justinianit në shek.VI të e.s. Monumentet më të rëndësishme që ruhen janë teatri me 50 shkallë, një nga më të mëdhenjtë e llojit të vet që njihen deri më

sot, rrethimi i shenjtë me tempujt e Zeusit e Diones, dy hyjnitë e mëdha të Dodonës dhe thesari, godina ku vendoseshin dhuratat kushtuar këtyre hyjnive. Më tepër se si qytet, Dodona është e njohur për orakullin e vet. Orakulli ushtronte ndikim të madh jo vetëm në konceptimin e besëtytnive mitologjike, po edhe mbi ngjarjet politike të kohës.



Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja BESA si duket kanë mësuar nga pësimi në zgjedhjet parlamentare dhe në rrethin e parë të zgjedhjeve lokale, ndërsa tanimë kanë synim të përbashkët të vazhdojnë koalicionin mes vete edhe në të ardhmen. Të dyja partitë presin mbarimin me sukses të Kongreseve partiake që të formalizojnë bashkëpunimin mes tyre

PRESIN KONGRESET PËR TË FORMALIZUAR BASHKËPUNIMIN

BESA DHE ASH TË SIGURT NË KOALICION



AFRIM GASHI

U bë mirë që përfundimisht në raundin e dytë u krijuan linqe të mira të komunikimit me ASH-në dhe kishim një zotim të ndërsjellë për përkrahje të njëra-tjetres me dëshirën që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen. Jam shumë optimist se ky bashkëpunim do të thellohet me atë që do të shkojmë bashkërisht në zgjedhjet parlamentare të radhës, me çka do të vijë ndryshimi i shumëpritur në skenën politike shqiptare



FLAKRON BEXHETI

Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja BESA, në zgjedhjet parlamentare kurdo që të mbahen ato, do jetë fitues i padiskutueshëm në kampusin politik shqiptar. Ky bashkëpunim ka për qëllim të faktorizojë votuesin shqiptarë, drejt një barazie të plotë ekonomike dhe politike me atë maqedonas. Dhe besoj se do ja arrijmë me një përkushtim serioz dhe me përkrahje absolute nga popullata shqiptare

ajo gjë nuk ndodhi", thotë Gashi. Ai kujton faktin se në raundin e dytë të zgjedhjeve lokale u bë i mundur bashkëpunimi me ASH-në, ndërsa është i sigurt se ky bashkëpunim do të thellohet në të ardhmen. "U bë mirë që përfundimisht në raundin e dytë u krijuan linqe të mira të komunikimit me ASH-në dhe kishim një zotim të ndërsjellë për përkrahje të njëra-tjetres me dëshirën që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen. Jam shumë optimist se ky bashkëpunim do të thellohet me atë që do të shkojmë bashkërisht në zgjedhjet parlamentare të radhës, me çka do të vijë ndryshimi i shumëpritur në skenën politike shqiptare", thekson Gashi. Njëjtë si Gashi nga BESA, edhe Flakron Bexheti nga ASH duke qenë i sigurt në vazhdimin e koalicionit mes dy partive, thotë se ky koalicion do të jetë fitues i padiskutueshëm i zgjedhjeve parlamentare kurdo që të mbahen ato. "Në anëtarësinë tonë eksiton disponimi dhe vullneti pozitiv për ta vazhduar edhe më tej bashkëpunimin me Lëvizjen BESA, ngase zgjedhjet lokale treguan se ky bashkëpunim funksionoi dhe u prit mirë nga votuesit shqiptarë. Koalicioni Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja BESA, në zgjedhjet parlamentare kurdo që të mbahen ato, do jetë fitues i padiskutueshëm në kampusin politik shqiptar. Ky bashkëpunim ka për qëllim të faktorizojë votuesin shqiptarë, drejt një barazie të plotë ekonomike dhe politike me atë maqedonas. Dhe besoj se do ja arrijmë me një përkushtim serioz dhe me përkrahje absolute nga popullata shqiptare", tha Bexheti. Por lidhur me formën dhe mënyrën si do të funksionojë ky koalicion, të dyja partitë presin që kjo të dihet vetëm pas Kongreseve partiake. Lëvizja BESA do të mbajë Kongresin e parë

zgjedhor më 24 shkurt të këtij viti, ndërsa Aleanca për Shqiptarët më 11 mars. Pikërisht mbajtja e kongreseve pa përçarje dhe me struktura të reja pritet të ndikojë edhe në bashkëpunimin e mirë në dukje mes këtyre partive. Kjo, pasi ka zëra se tek lëvizja BESA, përveç kandidatit Bilall Kasami që udhëheq me këtë parti për afër tre vite, aktualisht brenda partisë ka persona që kanë shfaqur ambicie për kryetar, por që ende nuk janë formalizuar në Komisionin zgjedhor. Edhe tek ASH ndonëse shihet një unitet më i madh në parti, brenda struktura-ve ka zëra të pakënaqur për braktisjen e Qeverisë, por jo aq sa të mund të krijojnë grupe të forta dhe të sfidojnë kryetarin aktual, Ziadin Sela, për të vazhduar ti prijë edhe më tej partisë.

Tek partitë tjera, RDK e Vesel Memedit vazhdon koalicionin "Aleanca për Shqiptarët" me partinë e UNITETI-t të Gëzim Ostrenit - parti këto që janë në partneritet qeveritar me BDI-në dhe LSDM-në. Kur jemi tek bashkëpunimet në të ardhmen në raport me Qeverinë, BDI duke pasur një bashkëpunim me PDSH-në, ka gjasa që kjo e fundit të ofrohet në Qeveri. Në lidhje me bashkëpunimet parazgjedhore mbetet të shihet nëse do të ndryshojë sistemi zgjedhor. LSDM kur ishte në opozitë ishte këmbëngulëse që të kalohet në Një njësi zgjedhore, por që u kundërshtua nga VMRO dhe BDI. Në BDI nuk kanë parapëlqyer të kalohet në Një njësi zgjedhore për faktin se nuk janë të sigurt se do të rritet pozicioni politik shqiptar. Bazuar në koalicionin që patën BDI dhe LSDM në zgjedhjet lokale, në opinion qarkullojnë zëra se në zgjedhjet parlamentare të radhës këto dy parti mund të jenë në koalicion parazgjedhor.



Seanca e parë e 2018-ës nis me Ligjin për shqipen

Shkup, 5 janar - Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi, për më 9 janar ka caktuar gjatë seanca parlamentare, midis të cilave edhe seanca e 27-të në të cilën në rend dite janë edhe përzgjedhja e gjykatësve kushtetues dhe Propozim-ligji për përdorimin e gjuhëve. Ende është e paqartë nëse shumica qeveritare do t'i votojë ligjet dhe vendimet tjera pa opozitën duke e pasur parasysh se VMRO-DPMNE-ja ende nuk ka vendim nëse do të përfshihet në punën e Parlamentit. Edhe të premten nga VMRO-DPMNE-ja thonë se ende nuk ka ndryshim në qëndrimin e tyre për kthim në Parlament. Lideri i partisë Hristijan Mickovski mbrëmë në një intervistë paralajmëroi se së shpejti do të publikohen hapa të reja të partisë, midis të cilave edhe veprimet e deputetëve, duke potencuar se për këtë ka debat serioz. Xhaferi në takimin para Vitit të Ri me gazetarët shfaqti shpresë se deputetët e opozitës nuk do ta vazhdojnë mungesën, për shkak se para Vitit të Ri për më 9 janar anuluar një pjesë e madhe e seancave. "Pritjet janë se të gjitha ato trazira brenda në partitë politike që kanë ndodhur në fund të vitit (2017) të tejkalohen edhe ditët e para të punës së Parlamentit, nga 9 janari e tutje pritet e mia janë se Kuvendi të jetë në përbërje të plotë me pjesëmarrjen e opozitës dhe të gjitha partive politike, duke i pasur parasysh edhe deklaratat e tyre paraprake se do të jenë të pranishme dhe veçanërisht për ligjet reformuese dhe në kontekst të pritjeve nga Raporti i KE-së dhe përparimin e RM-së", deklaroi Xhaferi. Në seancën e 26-të në rend dite janë ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit për sigurim pensional dhe invalidor, me procedurë të shkurtuar, me procedurë të shkurtuar, në seancën e 22-të janë ndryshimet dhe plotësimet e reformave të Ligjit për mbrojtje të dëshmitarëve dhe Propozim ligjit për ndërprerjen e vlefshmërisë së ligjit për Këshillin për konfirmimin e fakteve dhe ngritjen e procedurës për konfirmimin e përgjegjësisë për gjykatës, të dyja me procedurë të shkurtuar.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 5 janar - Në lidhje me bashkëpunimin mes partive shqiptare në të kaluarën - nuk ka çka të tregohet për diçka pozitive si para zgjedhjeve parlamentare dhe lokale, ashtu dhe më pas për të faktorizuar interesin kombëtar. Si në PPD ashtu dhe në PDSH me çarjen e saj dhe krijimin e Demokracisë së RE dhe me LR-PDSH-në, tani Aleanca për Shqiptarët ashtu dhe me BDI me formimin e partisë së Hysni Shaqirit dhe tani së fundmi me UNITETI-n e Gëzim Ostrenit, dëmtoi në masë të konsiderueshme pozicionin politik shqiptarë në Maqedoni. Ndonëse është herët të flitet, por edhe vonë jo për zgjedhje të parakohshme kur dihet se në rast të ndryshimit të emrit - zgjedhjet e reja parlamentare janë pothuajse të pashmangshme. Ndoshta mund të vijë në situatë që përfundimisht partitë shqiptare të mbledhin mend e jo të luftojnë me çdo kusht njëra-tjetër që të bashkëpunojnë dhe të kushtëzojnë palën maqedonase për barazi të plotë të shqiptarëve me maqedonasit në vend. Kjo, pasi partia në pushtet ka një afrim të madh me BDI-në edhe përkundër rivalitetit të ashpër ndër vite, ndërsa Aleanca për Shqiptarët dhe Lëvizja BESA si duket kanë mësuar nga pësimi në zgjedhjet parlamentare dhe në rrethin e parë të zgjedhjeve lokale, ndërsa tanimë kanë synim të përbashkët që të vazhdojnë koalicionin mes vete edhe në të ardhmen.

Në këtë drejtim, sekretari i përgjithshëm i Lëvizjes BESA, Afrim Gashi, thotë se partia e tij çdoherë ka pasur qëllim primar unifikimin e faktorit politik shqiptarë, por se - siç thotë ai, për shkak të kuajve të Trojës ka dështuar bashkëpunimi. "Lëvizja BESA që nga themelimi i saj ka pasur dëshirë që të unifikojë faktorin politik shqiptarë dhe ka pasur negociata të shumta dhe dëshirë për bashkëpunim me partitë tjera opozitare shqiptare, por ja që para zgjedhjeve lokale - për fat të keq dhe për shkak të shumë kuajve të Trojës,

STOLTENBERG NË SHKUP, BISEDIME PËR EMRIN NË NJU-JORK

EMRI, AMERIKANËT NISIN PRESIONET

Vizita e Stoltenbergut më 17 dhe 18 janar, në Athinë sikurse në Shkup, por edhe në mediat ndërkombëtare vlerësohet si intensifikim të aktiviteteve për zgjidhjen e problemit me kontestimin grek të emrit të Maqedonisë, ndërsa përmendet edhe presioni që SHBA-të po i bëjnë Greqisë



Ji: VULLNET POLITIK EDHE NË SHKUP EDHE NË ATHINË

Zëvendësndihmësi i sekretarit amerikan të shtetit i angazhuar për Çështjet Evropiane dhe Euroaziatike, Hojt Brajan Ji vlerëson se ka vullnet politik edhe në Shkup edhe në Athinë për zgjidhjen e kontestit me emrin. "Mendoj se Maqedonia ka mundësi në vitin 2018 përfundimisht ta zgjidh kontestimin me emrin me Greqinë. Për herë të parë pas një kohe të gjatë ka vullnet politik edhe në Shkup edhe në Athinë, edhe Maqedonia ka mundësi ta realizojë këtë qëllim", thotë Ji në intervistën për TV N1. Siç thekson, NATO ka politikë të dyerve të hapura, askënd nuk detyron të bëhet anëtare, ndërsa ato vende të cilat i përmbushin kushtet për anëtarësim janë të mirëseardhura.

Shkup, 5 janar - Aktivitete intensive janë paraparë këtë muaj në procesin e negociatave midis Athinës dhe Shkupit për tejkalimin e kontestit rreth emrit. Për më 19 janar është caktuar takim i ri në Nju-Jork i ndërmjetësuesit Methju Nimic me përfaqësuesit e Greqisë dhe të Maqedonisë, ndërsa sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, do ta vizitojë Shkupin më 17 dhe 18 janar. Më 18 janar në mesditë, Stoltenberg do të ketë fjalim para deputetëve në Parlamentin e Maqedonisë, ndërsa është paraparë të takohet me presidentin Gjorge Ivanov, me kryeministrin Zoran Zaev, me liderin e opozitës, Hristijan Mickovski, si dhe me ministrin e Punëve të Jashtme, Nikolla Dimitrov dhe me ministren e Mbrojtjes, Radmilla Shekerinska. Vizita e Stoltenberg, në Athinë sikurse në Shkup, por edhe në mediat ndërkombëtare vlerësohet si intensifikim të aktiviteteve për zgjidhjen e problemit me kontestimin grek të emrit të Maqedonisë, që e pengon integritetin e Maqedonisë në NATO dhe në BE. Gazeta gjermane "Zidvest Presse", ndërkaq shkruan se kryeministri grek, Aleksis Cipras, tashmë i është nënshtruar një presioni të fuqishëm nga ana e SHBA-së për zgjidhjen e kontestit. Gazeta thekson se lëvizja e kontestit rreth emrit të Maqedonisë ka të bëjë me ndryshimin e udhëheqësisë politike në Shkup. Sipas "Zidvest Presse", kontesti me emrin është çështja e cila seriozisht e prek diplomacinë ndërkombëtare, sepse "bëhet fjalë për kontest me përmasa gjeopolitike, që dukshëm i tejkalon edhe kufijtë e rajonit".

Gazeta përqendrohet edhe në

rolin e ndërmjetësuesit ndërkombëtar Methju Nimic, duke theksuar se "ai 25 vjet investon përpjekje për të ndërmjetësuar në kontestin, i cili shumë vështirë mund të kuptohet nga opinioni jashtë Ballkanit". Emri i ndërlikuar me përcaktim gjeografik për përdorim gjithëpërfshirës është pozita e Qeverisë greke për çështjen për emrin e Maqedonisë. Televizioni ERT thekson se shefi i diplomacisë greke, Nikos Koxias, në takim ka kërkuar pajtim nga të gjitha forcat politike për këtë çështje. artia kryesore opozitare Demokracia e Re, sipas gazetës "Katimerini", mendon se Panos Kamenos, lideri i koalicionit më të vogël partner në Qeverinë e Ciprasit, të "Grekëve të pavarur" është pajtuar për çdo kompromis për kontestin për emrin, vetëm për ta

mbajtur pozitën në pushtet.

Gazeta "Kontranjuz" pohon se të enjten është mbajtur takim i fshehtë në katër sy midis Cipras dhe Panos Kamenos në të cilin është dashur "të thyhet akulli". Menjëherë pas atij takimi, Cipras ka revokuar takim në të cilin ka marrë pjesë edhe zëvendëskryeministri Janis Dragasakis, shefi i diplomacisë Kocias dhe anëtarë të tjerë të Kabinetit. Gazeta "Vima" shtron pyetje nëse ngjarjet rreth Maqedonisë do të "lindin" ndonjë parti të re demokratike në Greqi, për shkak të faktit se mjaft deputetë nga Demokracia e re nuk e pranojnë përdorimin e emrit "Maqedoni", si emër i ri eventual të shtetit. Sipas gazetës, sjellja e atyre deputetëve ka shkaktuar debat të mundshëm për atë nëse duhet të krijohet parti e re me

orientim djathtist. Gazetat greke dje cituan deputetë grekë, të cilët japin propozime për emrin e ri të Maqedonisë, si për shembull "Dakia", "Mizia", "Republika qendrore ballkanike" etj. Ndërkohë në Maqedoni, Qeveria thotë se nuk është biseduar akoma për emër potencial. "Po ndërtohet besimi mes dy qeverive, moment i ri i miqësisë", tha të premten para gazetarëve zëdhënësi qeveritar, Mile Boshnjakovski. Duke u përgjigjur në pyetje të gazetarëve, Boshnjakovski potencoi se qëllimi është zgjidhja të arrihet në interes të të gjithëve. "Negociatat po zhvillohen nën patronatin e Kombeve të Bashkuara, me ndërmjetësim të Methju Nimicit. Procesi është publik dhe transparent. Gjithnjë derisa nuk ka diçka konkrete dhe specifike, nuk do të nxjerrim në ankand emra potencial", theksoi Boshnjakovski. Qeveria, siç theksoi ai, në mënyrë të hapur dhe të qartë qëndron në pozitën se nuk ka paragjykime të bisedojë për të gjitha çështjet dhe zgjidhjet të cilat do të thonë avancim të marrëdhënieve mes Maqedonisë dhe Greqisë dhe të cilat janë në interes të qytetarëve. Këtë përgjigje Boshnjakovski e dha edhe në pyetjen nëse po bisedohet për ndryshim të mundshëm të emrave të aeroportit të Shkupit dhe autostradës "Aleksandri i Madh". "Po punojmë intensivisht në ndërtimin e masave të besimit. Gjithçka që ndodhi gjatë periudhës së kaluar është në atë drejtim. Qeveria e Maqedonisë pret të gjitha vendimet e ardhshme të sinkronizohen dhe në pajtueshmëri nga të dy anët, si dhe ta projektojnë dinamikën e paraparë të proceseve integruese euroatlantike të Maqedonisë", tha Boshnjakovski.

KE PRET REZULTATE KONKRETE PËR KONTESHTIN ME EMRIN

Komisioni Evropian i përshëndet aktivitetet e Qeverisë së Maqedonisë për t'i dhënë fund kontestit 25 vjeçar për emrin me Greqinë dhe shpreson se do të shohë rezultate "konkrete", deklaroi një përfaqësues i Komisionit për "Euroaktiv". Ndërtimi i marrëdhënieve të mira midis vendeve fqinje, duke i përfshirë edhe zgjidhjen e përbashkët të pranueshme për çështjen për emrin, nën mbështetjen e KB-së, është nga rëndësia kyçe, theksoi përfaqësuesi i KE-së. "Në këtë kontekst i

përshëndesim hapat e ndërmarra nga qeveria në Shkup në mënyrë aktive të angazhohet me partnerët e tyre nga Greqia për përfortimin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, të cilat presim të përktihen në rezultate konkrete", thekson përfaqësuesi i KE-së. "Euroaktiv" thekson edhe për rritjen e optimizmit në Shkup, Athinë, Bruksel dhe Uashington, se kontesti shumëvjeçar për emrin përfundimisht do të zgjidhet, që Maqedonisë do t'ia hapë dyert për integrim në NATO dhe BE.

Emri, koha për vendime

Athinë, 5 janar - Kryeministri grek Aleksis Cipras sërish porositi se është optimist për çështjen për emrin, por pret edhe hapa konkrete nga ana e Maqedonisë. Mendon se sivjet hapet dritarja e mundësive për zgjidhje dhe është e nevojshme të sillen vendime adekuate. Kryeministri grek, siç lajmëroi korrespondenti i MIA-s nga Athina, sërish publikisht flet për kontestin midis Maqedonisë dhe Greqisë. "Viti 2018, është rol i rëndësishëm për Greqinë, jo vetëm pasi që tetë vjet të plota, përfundimisht dalim nga memorandumet, por edhe për shkak të asaj që njëkohësisht hapet një dritare e rëndësishme e mundësisë për zgjidhjen e emrit. Jam i bindur se tani ka ardhur koha për t'i sjell vendimet e nevojshme, për ta arsyetuar rolin e Greqisë si fuqi udhëheqëse e Ballkanit, por edhe si shtyllë e stabilitetit në rajonin më të gjerë", thotë Cipras për edicionin e sotëm të gazetës "Nea Selida". Sipas kryeministrit grek, Greqia para vetes ka edhe sfidë ekonomike dhe gjeopolitike, ndërsa është e nevojshme të ndërtojë, si në ekonominë, ashtu edhe në politikën e jashtme, "fizionomi të re dinamike të një vendi modern demokratik i cili investon në zhvillim, paqe dhe ndërtimin e besimit, të një vendi i cili përparon dhe zgjidh problemin". Qeveria greke, siç thotë Cipras, ka edhe vullnet edhe aftësi për ta garantuar këtë vijim të vendit. Aleksis Cipras edhe njëherë jep kritika deri te Demokracia e re opozitare, duke thënë se, për tani, merr pozitë të papërgjegjshme, duke harruar në "përgjegjësinë historike për moszgjidhjen e problemit në të kaluarën dhe të vendimit pozitiv nga Bukureshti". Cipras, në intervistë, shfaq shpresë se opozita do të kuptojë se çështja për emrin nuk duhet të jetë subjekt i lojërave brenda-partiake dhe nëse ekziston perspektivë për zgjidhje, do të krijohen parakushte për konsensus të gjerë parlamentar.

VMRO kundër ndryshimit të emrit kushtetues

Shkup, 5 janar - Personalisht unë dhe VMRO-DPMNE është kundër ndryshimit të Kushtetutës që do të thotë ndryshim të emrit kushtetues. Kështu tha lideri i ri i VMRO-DPMNE-së, Hristian Mickovski, në një intervistë për RTVM-në, ndërsa shtoi se VMRO për momentin është jashtë procesit për zgjidhjen

e çështjes për emrin sepse askush nuk i ka ftuar të jetë pjesë e procesit, e as që ka çfarëdo informacioni çka po ndodh zyrtarisht, e as jozyrtarisht. "Mund vetëm të parashikojmë çka do të bëhet dhe kur do të bëhet. Pajtohem se viti filloi në mënyrë intensive, ka mjaft informacione, por gjithë atë që ne

e dimë e mësojmë nga mediat dhe nuk mund të them as detaje as specifike", tha Mickovski. Ai theksoi se është e nevojshme zgjidhje dinjitoze dhe mbyllje sa më të shpejtë të problemit, por ai dhe partia janë kundër ndryshimit të Kushtetutës dhe angazhohen për denoncimin e qytetarëve në referendum.

Mickovski u përqendrua edhe në dhunën në Kuvend më 27 prill të vitit të kaluar, duke vlerësuar se kjo ishte dëmi më i madh i interesave të partisë së tij. "Ne këtë deri më tani e kemi dënuar disa herë. Por, gjithashtu, e kemi dënuar edhe aksionin, i cili e shkaktoi këtë reagim, e ai ishte mënyra në të cilën u

përzgjedh kryetari i Kuvendit", tha kryetari i ri i VMRO-DPMNE-së. Ai paralajmëroi se do të parashtrijë propozim-ligj për amnisti deri te Kuvendi për të dyshuarit për ngjarjet e 27 prillit. Mickovski nuk tregoi nëse dhe kur deputetët e opozitës do të mund të kthehen në vendet kuvendore.

OMBUDSMANIT DO T' I RRIKEN KOMPETENCAT

KONTROLL QYTETAR PËR PUNËN E POLICISË



Në rritjen e kompetencave të Avokatit të Popullit parashihet edhe vendosja e mekanizmit për kontroll qytetar. Pjesë e këtij Këshilli (mekanizmi qytetar) do të jenë tre anëtarë të jashtëm që duhet të vijnë nga sektori civil

Koha

Omer XHAVERI

Shkup, 5 janar - Qeveria e Maqedonisë i ka dhënë dritë jeshile propozim-ligjit për rritjen e kompetencave të Ombudsmanit, në pjesën e mbikëqyrjes së nëpunësve policisë dhe gardianëve të burgjeve. Ndryshimet ligjore për Avokatin e Popullit, të cilët Parlamenti pritet të miratojë në periudhën që pason, parashohin krijimin e një trupi të jashtëm, si korrektues shtesë për sistemin hetues të veprave penale të kryera nga pjesëtarët e MPB-së dhe atyre të policisë së burgjeve. Në arsyetimin e miratimit të ndryshimeve të Ligjit për Ombudsmanin, nga Ministria e Drejtësisë kanë theksuar se kontrolli i policisë duhet të bëhet në pajtim me Konventën ndërkombëtare për të drejtën e njeriut (KNDNJ) dhe të drejtën e saj presedante. Qëllimi kryesor, siç njoftojnë nga kjo ministri, është përforcimi i

mbrojtjes të lirive dhe të drejtave të njeriut në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës.

Standardet e theksuara pritet të arrihen përmes sigurimit të mbështetjes dhe mbrojtjes së viktimave, respektivisht interesat e tyre duhet të prezantohen në të gjitha procedurat, duke filluar nga hetimet transparente dhe efikase mbi veprave penale dhe shkeljet tjera të cilat i kryejnë pjesëtarët e policisë. Ndërkohë, plotësimi i këtij Ligjit për Ombudsmanin pritet të mundësojë iniciimin e revidimit të procedurave para sektorit special të Prokurorisë Publike, në raste kur është e nevojshme të bëhet. Tutje, në rritjen e kompetencave të Avokatit të Popullit, parashihet vendosja (siç është definuar në tekstin e ndryshimeve ligjore) e mekanizmit për kontroll qytetar. Pjesë e këtij Këshilli (mekanizmi qytetar) do të jenë tre anëtarë të

jashtëm që duhet të vijnë nga sektori civil, me çka paraprakisht ata duhet të kenë përvojë punë në sferën e të drejtave të njeriut, të drejtës policor dhe gjyqësorit. "Ombudsmani si mekanizëm për kontroll civil, theksin e vendos në procedurat/rastet aktuale të iniciuara me kërkesë të palës/viktimës apo familjes, me nismë të përfaqësuesve të sektorit civil, si dhe përmes iniciativave individuale (pas pranimit të informacioneve), për shkelje eventuale të të drejtave që burojnë nga KNDNJ. Kësisoj, me plotësimin e Ligjit për Avokatin e Popullit, të njëjtit do t'i shtohen kompetencat në drejtim të pavarësisë, kujdesit dhe përvojës në mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut", sqarojnë nga Ministria e Drejtësisë. Ndryshe, zyra e Ombudsmanit - mekanizmi për kontroll qytetar do të ketë qasje të drejtpërdrejtë deri te të gjitha informacionet dhe dësh-

mitë, pavarësisht shkallës së besueshmërisë dhe pa asnjë kushtëzim nga cilido organ apo person zyrtar. Ngjashëm si të gjitha aktivitetet e tija të deritanishme, Ombudsmani do të përgatis edhe raport për shkalën e sigurimit, respektimit dhe avancimit të të drejtave kushtetuese dhe atyre ligjore të qytetarëve. Krahas kontrollit qytetar, Qeveria javë më parë miratoi edhe një vendim i cili parasheh që në kuadër të Gjykatës Penale të Shkupit dhe Prokurorisë Publike, të formohet Reparti special për mbikëqyrjen e punës së policisë, respektivisht procedimin e rasteve penale të kryera nga nëpunësit e Ministrisë për Punë të Brendshme. Ky propozim i iniciuar nga Ministria e Drejtësisë, po ashtu ka kaluar në Qeveri, me çka pakoja prej disa ligjeve në aspektin e procedurave penale së shpejti pritet të përfshihet në debat parlamentar.

KRONIKË

Shkup, gjashtë aksidente me katër të lënduar

Katër persona janë lënduar më lehtë në tre nga gjithsej gjashtë aksidente të regjistruara gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup. Në tre aksidente është shkaktuar vetëm dëm material. Nga MPB-ja informojnë se dje policia rrugore ka zbuluar dhe sanksionuar një numër të madh të kundërvajtjeve. Dymbëdhjetë shoferë që kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, gjashtë shoferë të cilët kanë kaluar në të kuqe në semafor, tre shoferë që nuk u kanë dhënë përparësi kalimit të këmbësorëve dhe tre shoferë për tejkallim të papërshtatshëm. Nga komunikacioni janë përjashtuar tre shoferë, të cilët e kanë drejtuar automjetin nën ndikimin e alkoolit, 14 shoferë para se të marrin të drejtën e drejtimit të automjetit motorik si dhe dy shoferë fillestarë, si dhe 14 automjete teknikisht të parregulluara. Janë sanksionuar edhe 10 këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimit për ta. Janë hasur edhe 103 automjete të parkuara në mënyrë të papërshtatshme. Me ndihmën e automjetit special të karrotrecit, janë larguar 95 automjete.

Qëllon me pistoletë, ndalohet 26 vjeçari

Të enjten mbrëma rreth orës 23.00, është denoncuar se në afërsi të restorantit "Albis" në Gostivar, dëgjohen të krisma nga armë zjarri. Menjëherë në vendin e ngjarjes janë dërguar pjesëtarë të policisë nga stacioni policor i Gostivarit, të cilët pranë një makine të parkuar e tipit "Seat Ibiza" me targa të Austrisë kanë gjetur shumë gëzhoja plumbash. Në konsultim me prokurorin publik, është kryer ekspertizë në vendngjarje, gëzhojat e plumbave janë marrë, ndërsa është identifikuar edhe pronari i veturës 26-vjeçari me iniciale G.N nga Raveni i Gostivarit me shtetësi austriake. Në veturë është gjetur një pistoletë e tipit "Valter P 88 Kompakt", si dhe një kuti e zbrazur municioni, të cilat me vërtetim janë konfiskuar për analizë, përderisa G.N pak më vonë është ftuar në stacionin policor të Gostivarit për zbardhje të plotë të rastit, njofton Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë.

Arrestohet tetovari që kërkohet nga policia

Pjesëtarë të policisë nga Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë, të enjten rreth orës 10.00, kanë arrestuar 31-vjeçarin me iniciale G.J.S nga Tetova për të cilin është lëshuar urdhërarrest nga Ministria e Drejtësisë për shkak të ikjes nga burgu. Pas mbajtjes së shkurtër në stacionin policor të Tetovës, G.J.S është dërguar në burgun e Shtipit për të vuajtur dënimin me burg për veprën e kryer penale "dhunë", njofton policia. (U.H)

"Monstra" fillon më 12 shkurt

Shkup, 5 janar - Rigjykimi për rastin "Monstra" fillon me 12 shkurt. Lajmin për media e kanë publikuar nga Gjykata Penale e Shkupit, të cilët mes tjerash kanë njoftuar se Trupin gjykoës për këtë lëndë do ta udhëheq gjykatësi Ognen Stavrev, ndërkohë pjesë e Këshillit Penal do të jetë gjykatësi shqiptar Osman Shabani. Rifillimi i pro-

cesit gjyqësor për vrasjen e pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës, që ndodhi në vitin 2012, pritet të nisë nga e para, pasi muaj më parë Gjykata Supreme e shfuqizoi aktakuzën e Gjykatës Penale të Shkupit dhe asaj të Apelit. Cënimi i të drejtës të palës mbrojtëse dhe mos lejimi që avokatët dhe të akuzuarit të kenë qasje deri te dëshmitë ma-

teriale në rastin "Monstra", ishin arsyt kryesore se pse Gjykata e Lartë me kërkesë të prokurorisë publike i anuloi vendimet e dy instancave më të ulëta gjyqësore. Sipas të gjitha gjasave, fillimin e rigjykimit për "Monstrën" do ta përfaqësojnë nga Prokuroria për krim të organizuar, ndërkohë paralelisht me ndryshimin e Ligjit për mbrojtjen e

dëshmitarëve, kjo lëndë pritet t'i delegohet Prokurorisë Speciale Publike. Ndryshe, tre vite pas publikimit të "bombave" të para nga ana e LSDM-së (opozitë atë kohë), shumë herë është përfolur për përmbajtjen e materialeve të përgjuara lidhur me këtë rast, megjithatë nga PSP-ja deri më sot nuk kanë dhënë asnjë detaj për këtë çështje. (O.Xh)

Arsyet e kësaj situatë janë të njohura. Për të konkurruar me një dorëshkrim, ai duhet të jetë i shkruar patjetër në gjuhën maqedonase, mirëpo pavarësisht aktit-MASH nuk ka bërë asgjë për të ndryshuar situatën. Për pasojë, situata me pjesëmarrjen e autorëve shqiptarë është jashtë çdo normaleje

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 5 janar - Ndryshimi i parajlmëruar i programeve mësimore, respektivisht teksteve shkollore veçmë ka filluar. Nga Shërbimi Pedagogjik i Ministrisë të Arsimit dhe Shkencës (MASH) njoftohen të gjithë botuesit se ka përfunduar hartimin i programeve të reja mësimore nga lëndët e gjuhëve të huaja për vitet e katërta të arsimit të mesëm. Pra, botuesit nga vendi dhe të huaj, mund të konkurrojnë për botimin e librave a atyre librave, që sipas të gjitha gjasave, do të jenë gati për vitin e ardhshëm shkollor 2018/2019, pasi Programet mbi bazën e të cilave duhet të punohen librat përkatës - veçmë janë miratuar nga MASH-i. Bëhet fjalë për libra të shkollave të mesme, të cilat përdoren në drejtimin gjimnaz apo drejtimet të mesme profesionale katërvjeçare.

Ajo që bie në sy, në fondin e teksteve shkollore në Maqedoni veçanërisht gjatë dekadës së fundit

SKANDALOZE PJESËMARRJA NË TEKSTET SHKOLLORE

NGA 525 LIBRA, 16 ME FIRMËN E AUTORËVE SHQIPTARË



është mungesa e autorëve shqiptarë. Pjesëmarrja e tyre është thuar simbolike dhe e limituar vetëm në tekstet e lëndës së gjuhës dhe letërsisë shqipe. Për shembull, nga 49 tekste shkollore që aktualisht janë në përdorim nga nxënësit e viteve të katërta, vetëm katër libra kanë autorë shqiptarë edhe atë tre tekste të gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe njëri nga dy librat e filozofisë. Të gjitha librat tjerë janë nga autorë maqedonas, duke përfshirë këtu librat e gjuhëve të huaja. Nuk është aspak më e mirë situata me librat e viteve të treta, të dyta dhe të para të arsimit katërvjeçar. Për 52 testet në përdorim, në vitet e treta vetëm pesë janë nga autorë

shqiptarë, ashtu sikurse për 42 tekste shkollore të viteve të dyta vetëm dy janë nga autorë shqiptarë apo si në rastin e 36 librave të viteve të para vetëm tri prej tyre janë nga autorë shqiptarë. Konkretisht, nga 179 libra të arsimit të mesëm të përgjithshëm nga autorë shqiptarë, janë vetëm 14 libra. Në arsimin e mesëm profesional, mungesa e librave nga autorë shqiptarë është ende më skandaloze. Nga 346 libra, të cilat përdoren në arsimin e mesëm profesional, të gjitha të drejtimeve firmën e autorëve shqiptarë e mbajnë vetëm dy libra, edhe atë nga një libër në vitin e parë dhe të dytë, ku janë në shfrytëzim 51, respektivisht 106 libra.

Ndërsa, për lëndët profesionale të viteve të treta dhe të katërta ku janë në përdorim 108, respektivisht 81 libra, nuk ka as edhe një autorë shqiptarë. Arsyet e kësaj situatë janë të njohura. Për të konkurruar me një dorëshkrim, ai duhet të jetë i shkruar patjetër në gjuhën maqedonase. Për pasojë, gjendja me pjesëmarrjen e autorëve shqiptarë në përpilimin e testeve shkollore është jashtë çdo normaleje. Marrë në përgjithësi në arsimin e mesëm profesional, për lëndët e përgjithshme dhe profesionale, nëse në total janë në përdorim 525 libra, vetëm 16 prej tyre janë nga autorë shqiptarë.

Bazuar në programet e reja më-

simore, nga viti tjetër shkollor do të ketë libra të rinj për katër lëndë edhe atë për gjuhën angleze si lëndë e parë e huaj, gjuhën gjermane, frënge dhe ruse si gjuhë të dyta të huaja në shkollat e mesme. Programet mësimore të këtyre lëndëve mund të gjenden në vebfaqet zyrtare të MASH-it, respektivisht Shërbimit Pedagogjik dhe Byrosë për Zhvillimin e Arsimit, që është organi kompetent profesional i MASH-it për çështjen e hartimit të programeve mësimore. Për momentin, librat e të gjitha lëndëve të gjuhëve të huaja në arsimin e mesëm janë të autorëve të huaj. Konkretisht, bëhet fjalë për tekste shkollore që zakonisht botohen në vendin e origjinës për fëmijë që nuk e kanë atë gjuhë si mjet të parë komunikimi dhe që përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit, pasi u blihet e drejta autoriale nga MASH-i, sillen në Maqedoni për tu shfrytëzuar si tekste shkollore. Tani që programet mësimore të anglishtes, gjermanishtes, frëngjishtes dhe rusishtes kanë ndryshuar - u hapet mundësia edhe autorëve dhe botuesve vendas të përpilojnë librat e atyre lëndëve. Këtë mund ta bëjnë edhe shtëpitë botuese të shteteve të huaja, por me kusht që të jenë të regjistruara në vendet amë dhe të ushtrojë veprimtari të paraparë sipas ligjeve të shteteve amë.

REVIZION PËR PROGRAMET E VITEVE TË KALUARA

NËN LLUPË ABUZIMET ME PROJEKTET E PAREALIZUARA

Koha Evis HALILI

Shkup, 5 janar - Ndërsa në Ministrinë e Kulturës shqyrtimit i projekteve për Programin nacional të kulturës është në proces, po ashtu janë nën monitorim edhe projektet e viteve të kaluara, të cilat nuk janë realizuar. Nga ky institucion nuk japin shifra të sakta lidhur me abuzimet me fondet e akorduara, për shkak se revizioni ende nuk ka përfunduar. Kështu pohon sekretari shtetëror Valmir Aziri, sipas të cilit, do të trefishohet mbështetja e Ministrisë së Kulturës në aspektin programor, por edhe përgjegjësia për realizimin e tij.

"Numri i projekteve shqiptare që do të miratohen këtë vit do të jetë i madh, ashtu si edhe mbështetja financiare që do t'i japim, ashtu jemi marrë vesh. Por,



njëkohësisht rritet edhe përgjegjësia, do të kërkojmë llogari deri në fund për realizimin e tyre. Pasi deri tani ka pasur një praktikë të shëmtuar, për financimin e projekteve të tilla të cilat asnjëherë nuk e kanë parë dritën e diellit. Nuk mund të jap detaje, pasi revizioni vazhdon, por e përsëris se kontrolli që do të bëjmë, do të jetë i rreptë", thotë Aziri. Numri më i madh i projekte-

ve të paraqitura këtë vit është në sektorin e botimeve. Numërohen mbi 450 projekte të tilla. Po ashtu, në numër të madh janë edhe projektet në skenën muzikore, në sektorin e dramës. Tek kjo e fundit prioritet do të jetë mbështetja e vetë institucioneve, si teatri i Kumanovës, Shkupit, e të tjera. Sa i takon festivaleve teatrore, si ai në Dibër, Gostivar, Strugë, por edhe Fe-

stivalit në Tetovë, i cili planifikohet të kalojë nën kompetencat e Qendrës së Kulturës, mbështetja do të jetë më e madhe këtë vit. Sipas Azirit, 30 për qind e Fondit për veprimtari drametike do të shkojë për këto festivale, në mënyrë që të funksionojnë në kushte më komode.

"Në Strategjinë që kemi për zhvillimin e kulturës në përgjithësi, por edhe për këtë vit - kryefjalë është qasja e barabartë për të gjithë qytetarët, pra disperzimi dhe demetropolizimi i kulturës. Në këtë frymë ne do t'i japim përparësi eventeve, festivaleve, apo shfaqjeve të cilat do të jenë sa më larg kryeqytetit, për të 'sponsorizuar' kështu edhe ata artistë që punojnë në periferi, pasi mbështetja ndaj kësaj kategorie ka qenë zero, ose simbolike. Dhe duke nisur nga festivalet si ai i Strugës, Gostivarit, Dibrës. Por

edhe ai i Tetovës që po dështon për shkak të problemeve që ka, e që planifikojmë ta kalojmë nën ombrellën e Qendrës së Kulturës", thotë Aziri.

Numri i projekteve që do të bëhen pjesë e Programit vjetor të Kulturës pritet të jetë më i madh. Sipas projekteve që kanë konkurruar në Ministrinë e Kulturës për Programin vjetor të kulturës, Ministria e Kulturës do të akordojë 900 milionë denarë për Buxhetin e Programit të këtij viti. Rreth 200 milionë denarë janë parashikuar për mbështetjen e projekteve për kulturën shqiptare, shumë kjo që sipas sekretarit shtetëror, Aziri, nënkupton trefishimin e mbështetjes financiare. Shpallja e rezultateve të konkurseve në të shtatë veprimtari të Ministrisë së Kulturës pritet të bëhet në mes të muajit janar.

RRUGË E PAPËRFUNDUAR DHE MUNGESË SHENJASH

RRETHRROTULLIMI PA SHENJË KOMUNIKACIONI



Në këtë rrugë, ku tashmë është ndërtuar edhe një rrethrotullim e ku drejtohen automjetet për tek stadiumi dhe më pas në drejtim të rrugës Tetovë-Jazhincë, orientimi i vozitësve është shumë problematik

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 5 janar - Një pjesë e bulevardit "Bllagoja Toska" që lidhet me rrugën tek Kazerma e qytetit të Tetovës vazhdon të jetë e papërfunduar. Rruga që u rregullua gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet lokale të vitit 2017, tashmë vazhdon të jetë një pengesë e madhe për drejtuesit e automjeteve të cilët përballen me mungesë të shenjave të komunikacionit. Në këtë rrugë, ku tashmë është ndërtuar edhe një rrethrotullim e ku drejtohen automjetet për tek stadiumi dhe më pas në drejtim të rrugës Tetovë-Jazhincë, orientimi i vozitësve është shumë problematik. Më shumë vështirësi hasin ata që për herë të parë kalojnë në këtë rrugë, e cila krahas mungesës së shenjave poashtu në vazhdimin e saj është e paasfaltuar dhe shpeshherë vozitësit vazhdojnë në atë

rrugë, e cila gjatë kësaj periudhe është pothuajse e pakalueshme. "Nuk kemi asnjë shenjë për të na orientuar që të vazhdojnë në rrugën regjionale. Prej verës së vitit të kaluar është në këtë gjendje. Disa herë kemi vazhduar drejt, por atje rruga është e papërfunduar dhe pa e rregulluar por që është me e keqja - nuk ka shenja paralajmëruese", thotë Bekimi, një vozitës nga Tetova. Ai apelon që në këtë unazë të vendosen shenja paralajmëruese sepse jo gjithë vozitësit e dinë se duhet të devijojnë për të dalë në rrugën kryesore. Krahas vozitësve të qytetit dhe rrethinës, problem është edhe për vozitësit që si destinacion kanë vendkalimin kufitar në Jazhincë dhe vështirë e kanë të orientohen në këtë pjesë të rrugës, sepse mungojnë shenjat elementare paralajmëruese që më lehtë ta kenë sidomos edhe automjetet e rënda.

Nga Komuna e Tetovës njoftuan se janë koordinuar me policinë që të vendosen shenja orientuese në këtë pjesë.

"Nga mbledhja e mbajtur të enjten në hapësirat e Sektorit për veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit jetësor dhe natyrë, me përfaqësues të Policisë, u vendos që në bulevardin 'Bllagoja Toska' në pjesën ku është në proces të ndërtimit përreth Kazermës të qytetit në unazën e ndërtuar, të vendosen shenjat e komunikacionit dhe njëkohësisht të ndalohet qarkullimi i komunikacionit në drejtim të rrugës regjionale Tetovë-Jazhincë dhe anasjelltas. Për momentin, jemi në fazën e projektit për shpronësimin e tokës ndërtimore të së njëjtës rrugë", tha Memet Jonuzi nga Sektori për veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit jetësor dhe natyrë pranë Komunës së Tetovës. Përndryshe,

kjo rrugë është asfaltuar gjatë muajit gusht të vitit të kaluar. Pikërisht zgjatja e punëve në këtë rrugë kishte bërë që komunikacioni të devijojë për në rrugë tjera, sidomos në pjesën për tek shkolla e muzikës dhe nëpër lagjen Cetinska që kishte krijuar edhe shumë kaos në komunikacionin rrugor në pjesën e qytetit për tek rruga Tetovë-Jazhincë, por e njëjta ka ngelur pa u përfunduar edhe për një pjesën e cila shfrytëzohet nga banorët e lagjes Drenovec që do të lehtësonte në masë të madhe edhe rrugën që është përgjatë stadiumit të qytetit. Shkak për këtë, sipas informacioneve, është mos përfundimi i eksproprijimit.

Nga Sektori për veprimtari komunale dhe mbrojtje të ambientit jetësor dhe natyrë pranë Komunës së Tetovës thonë se në muajin mars do të rifillojnë punët edhe në atë pjesë.

Për 11 muaj, eksporti rritet për 18.6 për qind

Shkup, 5 janar - Eksporti i mallrave prej Republikës së Maqedonisë nga janari deri në nëntor 2017 ka shënuar rritje prej 18,6 për qind. Vlera e mallit të eksportuar, sipas të dhënave të publikuara të Entit Shtetëror për statistikë, është 5.175.429 mijë dollarë amerikanë. Vlera e mallit të importuar, në të njëjtën periudhë, është 6.977.194 mijë dollarë amerikanë, që është për 13,8 për qind më shumë në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Deficiti tregtar, në periudhën janar-nëntor 2017, është 1.801.765 mijë dollarë amerikanë. Më shumë janë eksportuar katalizatorë të mbajtësve me metale të fisnikëruara ose bashëdyzimet e tyre, setet e përçuesve për ndezje dhe ngjashëm, për automjete, aeroplanë apo anije, automjetet motorike për transportimin e 10 ose më shumë personave, duke e përfshirë edhe shoferin, me motor me djegie të brendshme me ndezje me ndihmën e kompresionit (dizel ose gjysmëdizel) dhe veshje. Në periudhën janar-nëntor 2017, sipas vëllimit të përgjithshëm të këmbimit të jashtëm tregtar, Republika e Maqedonisë më së shumti ka tregtuar me Gjermaninë, Britaninë e Madhe, Greqinë, Serbinë dhe Bullgarinë.

Kotevski drejtor i Shutkës, Erkeçov i Inspektoratit të Ndërtimtarisë

Shkup, 5 janar - Gjoko Kotevski është drejtori i ri i Burgut Hetues të Shkupit në Shutkë, ndërsa Bore Erkeçov i Inspektoratit të Ndërtimtarisë. Siç kumtoi zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski, për plotësimin e vendeve drejtuese në institucionet e tjera do të vendoset në seancën e ardhshme të Qeverisë të martën. Kotevski vjen në "Shutkë" nga Drejtoria për Udhëheqjen e Librave Amë pranë Ministrisë së Drejtësisë.

PËR NJË JAVË, 128 TË INFEKTUAR TË RINJ NGA GRIPI

Shkup, 5 janar - Javën e kaluar (prej 25 dhjetorit deri më 31 dhjetor) në Republikën e Maqedonisë janë regjistruar 128 raste të reja të të infektuarve nga gripi, që nuk është rritje e madhe në krahasim me javën para kësaj (18 dhjetor deri më 24 dhjetor) kur u regjistruan 104 persona të infektuar, theksohet në raportin që në ueb faqen e tij e publikoi Instituti i Shëndetit Publik të Republikës së Maqedonisë.

Nga Instituti vlerësojnë se numri i rasteve të regjistruara javën e kaluar është disa fish më i vogël në krahasim me javën e njëjtë nga sezoni i kaluar kur u regjistruan 9.485 raste. Numri më i madh i të infektuarve (88) janë paraqitur në grupin e të rriturve prej 15-64 vjeç, ndërsa incidencë më e madhe prej 11,2 në 100.00 banorë është regjistruar te fëmijët e moshës prej 5-14 vjeç.

Numri më i madh i të infektuarve (25 raste) dhe incidencë më e madhe prej 90,1/100.000 është regjistruar në territorin e Njësisë rajonale të Dibrës. Në sezonin 2017/2018 numri i përgjithshëm i rasteve të paraqitura me infektim të ngjashme me gripin arrin 1.082. Në laboratorin e virusologjisë të Institutit janë testuar shtatë materiale për grip. Nga materialet e testuara, dy janë po-



zitive për prezencën e virusit të influencës B. Nga fillimi i sezonit 2017/2018, në ISHP arritën 73 materiale humane nga institucionet

e shëndetësisë prej të cilave vetëm tre (4,1 për qind) janë pozitive për prezencën e virusit - një A (H1N1) pdm dhe dy influenza B.

KULTURAT FITIMPRURËSE DUAN PAK IDE

ME BUJQËSI MUND TË JETOHET

Ekspertët bujqësor thonë se fermerët duhet të kenë ide për prodhimtari cilësore dhe të shpagueshme. Sugjerohet edhe analiza e investimit, kalkulimi i harxhimeve, si dhe të ardhurat e përafërta përpara se të fillohet me një prodhimtari të caktuar bujqësore. Vlerësohet se përkundër problemeve të ndryshme, megjithatë me një përkushtim dhe angazhim serioz, mund të jetohet në mënyrë solide nga prodhimtaria bujqësore dhe blegtorale

Sfidë e madhe për bujqësinë e Maqedonisë janë edhe parcelat e vogla dhe të shpërndara, që pamundësojnë rritjen e prodhimtarisë dhe konkurrencës së bujqësisë. Të dhënat tregojnë se në Maqedoni dominojnë parcelat e vogla bujqësore. Madhësia mesatare e ekonomisë bujqësore prej 2.5 deri 2.8 hektarë dhe madhësi mesatare e parcelës kadastrale prej 0.3 deri 0.5 hektarë janë nën madhësinë e parcelave të tokës bujqësore krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 5 janar - Probleme me plasmanin e sigurt të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale, kostoja e lartë e punës që shpesh nuk i mbulon as harxhimet, çmimet e ulëta të grumbullimit që diktohen nga tregtarët, mosrespektimi i kontratave për shitblerje, si dhe vonesat në pagesa të pemë-perimeve të grumbulluara... janë vetëm disa nga problemet që sot mundojnë prodhuesin bujqësor në Maqedoni. Ekspertët bujqësor thonë se fermerët duhet të kenë ide për prodhimtari cilësore dhe të shpagueshme. Sipas agronomëve, nevojitet të bëhet orientimi i prodhimit sipas predispozitave që kanë regjionet e caktuara për prodhimin e pemëve, perimeve apo prodhimeve blegtorale. Sugjerohet edhe analiza e investimit, kalkulimi i harxhimeve, si dhe të ardhurat e përafërta përpara se të fillohet me një prodhimtari të caktuar bujqësore. Vlerësohet se, përkundër problemeve të ndryshme, megjithatë me një përkushtim dhe angazhim serioz mund të jetohet në mënyrë solide nga prodhimtaria bujqësore dhe blegtorale. Sugjerohet që bujqësia të orientohet krahas kërkesës së tregut, edhe ndaj përpunimit dhe paketimit të prodhimeve me qëllim të ikjes së kokëçarjes së shitjes së tyre në treg.

TË ANGAZHOHET E TËRË FAMILJA

"Gati se nuk ekziston kulturë bujqësore nga e cila nuk mund të fitohet në mënyrë të kënaqshme

me marzha më të mëdha apo më të vogla të fitimit, si dhe koston e ndryshme që nevojitet për lloje të ndryshme të prodhimit. Por, në radhë të parë - prodhimtaria bujqësore kërkon posedimin e tokës në pronësi që të mos kemi harxhime shtesë për qiranë, si dhe posedimin e mekanizimit bujqësor. Një faktor tjetër që dikton suksesin është organizimi i punës në mënyrë të atillë që është e angazhuar e tërë familja, ose thënë ndryshe - bujqësia të jetë biznes familjar.", thotë eksperti bujqësor Lulzim Fejzullahu. Sipas tij, krahas traditës që luan një rol të madh në marrjen me bujqësi, një rëndësi të madhe ka edhe puna e palodhshme dhe angazhimi që çdo herë sjellin plasman dhe rezultat pozitiv.

"Gjithashtu, sallatat e gjelbërta, preshi, qepa, patatat apo karotat çdoherë kërkohen në treg dhe kanë plasman të sigurt. Por, në bujqësi çdoherë duhet edhe të investohet si në sistemet për vadijtje, paketim, cilësi që kërkohet në treg e kështu me radhë. Nevojiten edhe hulumtime se çka kërkohet në treg, ku për shembull - për dallim prej viteve të kaluara

kur molla nga Maqedonia kishte plasman në Shqipëri, tani për shkak të prodhimit të tyre vetanë, është ndalur eksporti i mollës nga Maqedonia në Shqipëri", thekson Fejzullahu.

Ai thotë se një vëmendje të veçantë kërkon edhe orientimi ndaj ofertës në treg të prodhimeve konkurruese me vlerë të shtuar e të dedikuar edhe për eksport - si tharja e hudhrës, përpunimi i domateve në keçap, boronicës në lëng e kështu me radhë. Vlen të mendohet edhe për kultivimin e bimëve aromatike dhe mjekësore, mjedrën, aroninë...

Njohësit e bujqësisë thonë se çdo rajon në Maqedoni ka prodhime me veçori karakteristike që dallohet edhe për nga cilësia. Andaj sugjerohet një angazhim më i madh i bujqve, blegtorëve, por edhe i biznesit, me qëllim që të krijojnë brende që nesër shumë më lehtë ti mund ti shesin edhe në tregjet rajonale dhe botërore, duke ndjekur shembujt e shteteve të ndryshme.

Agronomët thonë se prodhuesit e ushqimit dhe prodhimeve bujqësore në Maqedoni sa vjen e më shumë do të ballafaqohen me

presionin e madh të konkurrencës si në tregun vendor, ashtu edhe atë jashtëm në BE. Në periudhën e ardhshme, sugjerohet agronomët, nevojitet që sektori bujqësor-ushqimor ti afrohet sa më shumë standardeve të prodhimit dhe cilësisë të definuar me rregullativën e përbashkët bujqësor evropian.

PRODHIMI GJEOGRAFIK SJELL PËRFITIME

Ekonomistët gjithashtu thonë se brendimi i ndonjë prodhimi është më i lehtë nëse atij i shtohet prejardhja gjeografike. Për fillim nevojitet që ai të jetë cilësor me sasi të mjaftueshme në treg që të mundet në mënyrë konstante tu ofrohet blerësve. Ndryshe, sfida e madhe për bujqësinë e Maqedonisë janë edhe parcelat e vogla dhe të shpërndara, që pamundësojnë rritjen e prodhimtarisë dhe konkurrencës së bujqësisë. Të dhënat tregojnë se në Maqedoni dominojnë parcelat e vogla bujqësore. Madhësia mesatare e ekonomisë bujqësore prej 2.5 deri 2.8 hektarë dhe madhësi mesatare e parcelës kadastrale prej 0.3 deri 0.5 hektarë janë nën madhësinë e

parcelave të tokës bujqësore krahasuar me vendet e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, bujqësia në Maqedoni në vend të një dege ekonomike me potencial më të madh për punësim, në pjesën më të madhe është veprimtari ekonomike që zgjedh problemet sociale dhe ekzistenciale të një pjesë të konsiderueshme të popullatës. Sipas të dhënave zyrtare, pjesa dërmuese e ekonomive bujqësore, apo 58 për qind e tyre, për një hektar të tokës punuese fitojnë deri në 2000 euro për 12 muaj.

Gjithashtu, analizat tregojnë se orientimi ndaj prodhimit më rentabil dhe fitimit më të madh në sektorin e bujqësisë imponohet edhe nga produktiviteti i ulët në bujqësi dhe industrinë ushqimore, mungesë e kapitalit vetanë dhe qasje e vështirësuar ndaj kredive e ekonomive të vogla bujqësore, përfaqësimi jo i volitshëm i racave dhe sortave, pjesëmarrje e lartë e prodhimeve bujqësore me vlerë të ulët të shtuar-prodhime të papërpunuara ose gjysmë të papërpunuara në strukturën eksportuese të prodhimeve ushqimore-bujqësore dhe shpërndarje e pamjaftueshme sipas destinacioneve eksportuese.

Ndryshe, pjesa më e madhe e ekonomive bujqësore në vend për shkak të strukturës së tyre, nuk janë në gjendje që në mënyrë të barabartë të garojnë me prodhimet konkurruese bujqësore të prodhuesve evropian dhe botëror në raport me lartësinë e harxhimeve prodhuese dhe marketingut të prodhimeve.

KOMITETI PËR BUJQËSI DO T'I NDJEKË MASAT AGROSEKTOR

Nuk hiqet Agjencia për ushqim dhe veterinar, as që bëhet diçka me ingerenca mbi të sajat, tha të premten zëdhënësi i Qeverisë, Mile Boshnjakovski lidhur me vendimin e djeshëm të Qeverisë që të formohet Komiteti për bujqësi dhe siguri të ushqimit. "Detyra themelore e këtij Komiteti është që ta ndjek realizimin e masave dhe projekteve lidhur me agrosektorin, sigurinë

e ushqimit dhe mbrojtjen veterinarë të kafshëve dhe gjithsesi, të japë drejtime dhe propozime me qëllim që të përmirësohen gjendjet në këto sfera specifike", tha Boshnjakovski, duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve. Në Komitet nuk do të ketë punësim të reja. Kjo do të jetë strukturë nga kuadrot ekzistuese të institucioneve.

Mbi 30 për qind e fondit të dedikuar për këtë manifestim (mbi 10 milionë denarë) u akordua për aktivitetet që lidheshin me kulturën shqiptare, që në pjesën më të madhe iu ndanë grupeve dhe shoqërive folklorike (mbi 800 mijë). Po ashtu, një pjesë tjetër e aktiviteteve të zhvilluara në komunat shqiptare ishin performanca nga grupe roku, muzikë klasike, ekspozita të artit figurativ, mbrëmje poetike, e të tjera

MBI 10 MILIONË DENARË PËR KULTURËN JASHTË METROPOLIT



FOLK DHE ROK NË KOMUNAT SHQIPTARE

Koha Evis HALILI

Shkup, 5 janar - Koncerte, ekspozita, mbrëmje poetike..., gjithsej 82 projekte të ndryshme kulturore janë realizuar në qytete e fshatra si pjesë e manifestimit "Vala e re kulturore". Ministria e Kulturës këtë vit ndryshoi jo vetëm emërtesën, por edhe destinacionin dhe formatin e manifestimit tradicional, që vitet e tjera realizohej nga vetë komunat. Shoqëri kulturore, asosacione, artistë e të tjerë u bënë pjesë e këtij manifestimi të ndarë në dy faza që u mbyll në muajin dhjetor. Ndërsa vetë "Vala...", kaloi nëpër pjesën më të madhe të vendbanimeve shqiptare. Po ashtu, mbi 30 për qind e fondit të dedikuar për këtë manifestim (mbi 10 milionë denarë) u akordua për aktivitetet që lidheshin me kulturën shqiptare, që në pjesën më të

madhe iu ndanë grupeve dhe shoqërive folklorike (mbi 800 mijë). Po ashtu, një pjesë tjetër e aktiviteteve të zhvilluara në komunat shqiptare ishin performanca nga grupe roku, muzikë klasike, ekspozita të artit figurativ, mbrëmje poetike, e të tjera. Interesimi i aplikantëve për "Valën e re kulturore" ka qenë më i madh në fazën e parë të konkurimit, ndërsa në fazën e dytë janë paraqitur më pak projekte.

"Me valën e re kulturore u inkurajuan shoqatat, asosacionet, fondacionet dhe individët nga sfera e kulturës që të krijojnë projekte të pavarura ose koproduksione mes tyre, të atilla që të jenë lehtësisht të transferueshme nga një ambient

në tjetrin. Kështu u përmbush edhe një tjetër qëllim i manifestimit, që është demetropolizimi dhe decentralizim konkret i përmbajtjeve kulturore. Janë realizuar projekte inventive dhe inovative nga të gjitha sferat e kulturës, projekte me zhanre të ndryshme, shprehje dhe vlera bashkëkohore kulturore dhe artistike, si koncerte sofistike, kor, ansamble folklorike, grupe këngëtarësh...", thuhet në njoftimin e Ministrisë së Kulturës. Ky manifestim



Ky manifestim që për gati dhjetë vjet është zhvilluar muajve të verës, këtë vit u zhvendos për shkak të ndryshimeve që pësoi, por edhe dilemave që të mënjanohesh për shkak të borxheve të akumuluar

që për gati dhjetë vjet është zhvilluar muajve të verës, këtë vit u zhvendos për shkak të ndryshimeve që pësoi, por edhe dilemave që të mënjanohesh për shkak të borxheve të akumuluar. Qëllimi mbeti i njëjtë, demetropolizimi i kulturës dhe zhvendosja e ngjarjeve kulturore nga qendra në periferi, qytete e fshatra, ndërsa u realizua me moton që është bërë pjesë e strategjisë së re të Ministrisë së Kulturës - "kulturë tek të

gjithë - për të gjithë". Risi për këtë vit ishin edhe ambientet ku u zhvilluan aktivitetet. Përveç institucioneve, si shtëpive e qendrave të kulturës, u vunë në funksion edhe ambiente të tjera alternative, sidomos edhe të lokacione të braktitura të cilat "restartuan" si skena artistike. Në njoftimin e Ministrisë së Kulturës po ashtu thuhet se me dizajnin e konkursit u lehtësuan maksimalisht procedurat e aplikimit, duke mundësuar kështu akses edhe për ata artistë që nuk janë shumë të predispozuar për t'u marrë me formalitetet e aplikimit, por që kanë potencial kreativ dhe ide të mira, të cilëve iu është dhënë mbështetja e duhur për të tejkaluar këto procedura.

JANARI SHËNON DËMET E PARA

NË POLLOG, ÇDO DITË NGA DY-TRE AKSIDENTE

Policia e Tetovës në kronikën ditore njofton për tre aksidente që kanë ndodhur gjatë 24 orëve të fundit, ku lëndime kanë marrë katër persona

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 5 janar - Muaji janar ka filluar si është më keq në rrugët e Tetovës dhe të Gostivarit. Policia e Tetovës në kronikën ditore njofton për tre aksidente që kanë ndodhur gjatë 24 orëve të fundit, ku lëndime kanë marrë katër persona. Në raport njoftohet se të enjten rreth orës 13.00, në rrugën "171" në Tetovë ka ndodhur një aksident komunikacioni në të cilin janë përfshirë dy vetura, gjegjësisht një



veturë e tipit "Citroen" me targa të Tetovës, të cilën e ka drejtuar 32-vjeçarja me iniciale E.A nga Korita si dhe një tjetër veturë e tipit "Golf", gjithashtu me targa të Tetovës të cilën e ka drejtuar 50-vjeçari me iniciale SH.M nga Kamjani. Në këtë aksidenti, 32-vjeçarja E.A për pasojë ka marrë lëndime trupore dhe është dërguar në Spitalin klinik të Tetovës ku është mbajtur për shërim të mëtutjeshëm. Sipas të

dhënave fillestare që dalin nga ekspertiza e kryer në vendin e ngjarjes, shkak për këtë aksident është mosmbajtja e distancës së nevojshme përderisa dëmi i shkakuar material vlerësohet që jetë rreth 15 mijë denarë. Aksidenti tjetër është regjistruar në rrugën regionale Mavrovë-Dibër, në afërsi të manastirit "Shën Jovan Bigorski", të enjten rreth orës 15.00, kur një veturë e tipit "Opel Astra" me

targa të Italisë e drejtuar nga 38-vjeçari me iniciale H.F nga fshati Trebishtë, ka humbur kontrollin mbi automjetin dhe për pasojë ka dalë nga rruga. Nga dalja prej rrugës, bashkudhëtarët të cilët janë gjendur në veturë, 35-vjeçarja me iniciale A.F si dhe një 8 vjeçar kanë marrë lëndime trupore, dhe janë dërguar në Shtëpinë e shëndetit të Rostushës nga ku pas marrjes së ndihmës janë lëshuar për mjekim shtëpiak. Është kryer hetim në vendin e ngjarjes dhe si shkak për këtë aksident fillimisht supozohet që të jetë mos përshtatja e shpejtësisë me kushtet në rrugë, derisa dëmi i shkakuar material vlerësohet që të jetë rreth 200 mijë denarë. Aksidenti i tretë është regjistruar në rrugën regionale Gostivar-Sërbinovë, në mbikalimin për në vendbanimin e Cigllanës në të cilin janë përfshirë dy automjete. Një veturë e tipit "Reno

Clio", të cilën e ka drejtuar 44-vjeçari me iniciale PT nga fshatin Bellovisht i Gostivarit, si dhe një tjetër veturë e tipit "Volksfagen Vento", të cilën e ka drejtuar 50-vjeçari me iniciale D.M nga i njëjti fshat. Vozitësi i veturës së tipit "Reno Clio" për pasojë ka marrë lëndime trupore dhe menjëherë është dërguar në Spitalin e Gostivarit, ku i është ofruar ndihma e parë mjekësore dhe është mbajtur në spital për shërim të mëtutjeshëm. "Fillimisht si shkak për këtë aksident komunikacioni, sipas të dhënave të para që dalin nga ekspertiza e kryer në vendin e ngjarjes, është mospërshtatja e shpejtësisë me kushtet e rrugës, gjegjësisht vozitja e shpejtë përderisa dëmi i shkakuar material nga ky aksident komunikacioni vlerësohet që të jetë rreth 100 mijë denarë", njofton Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë.

Cikli i 8-shit

Nga Veton SURROI



1. Më 1988 përfundoi autonomia e Kosovës (kështu zyrtarisht konsiderohet në dokumentet e OKB/UNMIK dhe ato të Procesit të Vjenës të kryesuar nga presidenti Ahtisaari). Dhjetë vjet më vonë, më 1998, u përcaktuan parametrat ndërkombëtarë të Grupit të Kontaktit për zgjidhjen politike (dhe ushtarake) në Kosovë. Pastaj, dhjetë vjet më vonë, më 2008, u shpall "pavarësia e kushtëzuar", e arritur në Procesin Ahtisaari. Tash, në këtë cikël të "8-shit", dhjetë vjet më vonë, arritëm tek etapa e katërt, ku sërish përcaktohet ardhmëria e Kosovës, dhe sikur dy herët paraprake, në një kontekst negociator ndërkombëtar. Më 2018, pra, vendi do të hyjë në një proces të avancuar negociator, me të cilin duhet të vendoset se çfarë do të jetë modaliteti i marrëdhënieve mes Kosovës e Serbisë dhe, rrjedhimisht, çfarë do të jetë pozicioni i Kosovës në BE dhe OKB.

2. Shkasi për negociatat që do të përcaktojnë statusin e marrëdhënieve mes Kosovës dhe Serbisë nuk gjendet, paradoksisht, tek nevojat e Kosovës. Shkasi për negociatat gjendet tek Strategjia e integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE, e që pak a shumë përkthehet konkretisht në anëtarësimin e Serbisë dhe Malit të Zi në BE më 2025. Fuqitë e mëdha (në BE dhe jashtë saj) vlerësojnë se stabiliteti i Ballkanit Perëndimor varet në masë të madhe nga stabiliteti i Serbisë, e cila tregoi tërë potencialin shkatërrues në luftërat e zhbërjes së Jugosllavisë të viteve '90. Për më tepër, ky stabilitet varet gjithashtu nga largimi i Serbisë prej Rusisë, e kjo thuhet të bëhet më së miri me anëtarësim në BE.

Kosova, në këtë ekuacion të stabilizimit të Ballkanit nëpërmjet inte-

grimit, hyn në masë të madhe në rolin e pengesës së vetme të mbetur për integrimin e Serbisë në BE. Në kalendarin i cili tashmë gjendet në zyrat e BE-së, duke filluar nga kryetari i Komisionit, Juncker, Serbia duhet të akordojë një dokument obligues me Kosovën, të cilin BE-ja do ta konsiderojë si hap legal të normalizimit të marrëdhënieve, me të cilin Serbia do të konsiderohet të mos jetë importuese e problemeve të saj të brendshme në BE. Në njëzet vjetët e fundit ky është pozicioni negociator më komod i Serbisë. Integrimi i Serbisë në BE tash është shndërruar pothuajse në nevojë më të madhe të BE-së sesa të vetë Serbisë; rrjedhimisht, në BE do të ketë gjithnjë e më shumë disponim që të akomodohen kërkesat e Serbisë karshi Kosovës. Nëse në Procesin e Brukselit BE-ja që e gatshme (e Kosova me gabime strategjike u pajtua) që të negociohet për një lloj mbindërtimi në sistemin kushtetues të Kosovës, të trajtuar si shtet të kontestuar e të kontestueshëm, në procesin e vitit 2018 do të ketë edhe më shumë ndjeshmëri për konceptet e Serbisë. Njëzet vjetët e fundit ky është, çuditërisht, pozicioni më i disfavorshëm negociator për Kosovën. Më 1998, me gjithë okupimin dhe luftën, Kosova ishte në pozicionin ku fuqitë e mëdha anonin kah ajo, përfshirë në fund edhe ndërhyrjen ushtarake. Më 2008, po ato fuqi të mëdha që e çliruan Kosovën e shtynë pavarësinë e saj nëpërmjet vrimën e gjilpërës. Më 2018, fuqitë e mëdha që e shpëtuan Kosovën nga gjenocidi, e çliruan atë nga okupimi dhe në fund e çuan për dore deri në pavarësi, kanë interes që Serbia të hyjë në BE dhe që kështu të

përmbillen konfliktet në Ballkanin Perëndimor.

3. Sfidat negociatore për Kosovën janë jashtëzakonisht të mëdha. Siç u pa në Procesin e Brukselit, Kosova shkoi në negociatat pa konsensus e me tepri arrogancë e injorancë bashkë. Ky proces ka lënë shenjë, sepse ka hapur rrugë presedence, siç ishte Marrëveshja për Bashkësinë e komunave serbe. Dhe ky proces nuk dha përgjigje për pyetjet sfiduese që i ka Kosova. Së pari, a do të çojnë negociatat në njohjen e pesë shteteve të BE-së, pa të cilat Kosova nuk ka pozitë të barabartë (pra perspektivë integrimi në BE)? Dhe a do të çojnë këto negociatat në anëtarësim në OKB, për ç'gjë nuk merret vetëm pëlqimi i Serbisë, por më me rëndësi i Kinës dhe Rusisë? Këto nuk janë pyetje akademike, por jetike për shtetësinë e vendit, dhe do të duhej të përcaktonin qëndrimin e negociatorëve të ardhshëm kosovarë. Nëse procesi i vitit 2018 nuk e vendos Kosovën në formë të barabartë në BE, duke marrë shprehimisht njohjet e "pesëshes" që nuk beson në Kosovën e pavarur, përse duhet Kosova të jetë ndihmesë e Serbisë për integrim në BE? Nëse në fund të procesit të vitit 2018 Serbia deklaron që nuk i pengon ulësja e OKB-së për Kosovën, kush garanton që presidenti Putin e ministri i Jashtëm, Lavrov, nuk do të deklarojnë që Serbia nuk e udhëheq politikën e jashtme ruse dhe se e vetmja mënyrë se si Kosova të bëhet anëtare e OKB-së është nëse shtetet perëndimore ia heqin sanksionet Rusisë dhe e njohin aneksimin e Krimesë. Natyrisht, sfida mbi sfidat është vetë dokumenti që duhet ta nënshkruajnë dy shtetet. Për ilustrim: a është i natyrës transitore (duke hapur edhe një proces në të ardhmen) apo është dokument me të

cilin dy shtetet vendosin marrëdhënie diplomatike dhe i japin fund konfliktit? Nëse është i natyrës transitore, çfarë do të jetë procesi i ri që na pret? Nëse është i natyrës përfundimtare, si i trajton dëmet e luftës e të okupimit?

4. Në këtë situatë janë tri gjëra kyç që Kosova nuk guxon t'i bëjë. Një, të vazhdojë me negociatat siç ka bërë deri më tani. Procesin e Brukselit ka qenë mostër se si nuk duhet negociuar. Në vitin 2018 Kosova duhet të hyjë me një konsensus negociator: pushtet dhe opozitë (cilido pushtet e opozitë që mbetet apo bëhet gjatë këtij viti) duhet të veprojnë së bashku, me mbikëqyrje të plot parlamentare. Dy, të mos marrë pjesë në negociatat, apo të tregojë mosgatishmëri për të marrë pjesë. Ndonëse theksi i tyre është për anëtarësim të Serbisë në BE, këto mund të jenë rast i mirë për avancimin e interesave të vendit. Mosgatishmëria e një shteti për të negociuar për fatin e vet lë hije edhe më të madhe dyshimi mbi të seç ka akumuluar deri tani. Dhe tre, të vazhdojë rrugën e theqafjes që e shpërfaqti me veçanti në ditët e fundit të vitit 2017, duke u përpjekur të kontrabandojë shfuqizimin e Gjykatës Speciale, me gjithë kundërshtimet e hapura të shteteve që e mbrojtën, çliruan dhe pavarësuan Kosovën. Në njëzet vjetët e fundit nuk ka gjë të mirë që është bërë për këtë vend e që nuk është bërë me përkrahjen e jashtëzakonshme të shteteve kryesore perëndimore. Vendi ka kapacitet të madh dëmtimi, në negociatat apo jo, nëse nuk e ka përkrahjen vendimtare të këtyre shteteve. E dëmi mund të jetë i një gjenerate nëse nga këto negociatat, më 2018, del me rezultatet mjerane të arrogancës e injorancës së bërë bashkë. (koha.net)

Më 2018 sërish hyjmë në negociatat që përcaktojnë statusin tonë të ardhshëm. Rreziqet janë shumë të mëdha



KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e premtë 5 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 221 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup


NPK "Koha Production" Num. i xhirollogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

shtojcë enigmatike e fundjavës

FJALËKRYQI KLASIK

HORIZONTALISHT

3. Pjesë e qafës, grykë
5. Qëlloj dikë me grushta
7. Instalim i minave
9. Lloj ëmbëlsire
10. Stacion televiziv
12. Kryeqyteti i Marokut
13. Me të vërtetë (krahin.)
15. Prodhues poçesh
16. Mendim i formuar për dikë a për diçka
18. Bojë hiri, i përhimtë
20. Vegla
23. Rrymimi i ajrit
24. Filozof grek
26. Qytet në Sllovakia
28. Posedoj
29. Që lidhet me organin e të parit
30. Shtresë
31. Muzikanti kanadez, Kim Gaboury
33. Bukuroshja shqiptare në foto
41. Futbollist i Lionit, Bertrand
42. Britma e arkimedit
43. Veprim
44. Një muaj viti
47. Aktorja kroate, Rina
48. Bimë me erë të mirë
49. Mizor.



VERTIKALISHT

1. Mëkat
2. Smirë, resë
3. Shuaj
4. Këngëtarja Turner
5. Petka, veshje
6. Buf
8. Pyll
9. Lëndë ndërtimi për suvatim
11. Zakoni
12. Jevget
14. Një organ
15. Gjellë me oriz
17. Mjet për matjen e energjisë
18. Sëmundje ngjitëse
19. Kryeministri Edi
21. Trualli, vendi
22. Kryeneçësi
23. Erbiumi
24. Film nga Isa Qosja
25. Përemër pronor
27. Porosia që i jepet dikujt (sh.)
30. Mal në Per (ndryshe Hiwana)
32. Bashkëtingëllore e zanore
33. Toka e punuar
34. Pije alkooolike
35. Vit
37. Luteciumi
38. Floriri
39. E kundërta e brutos
40. Shkova
45. Këngëtar i anglez, Klepton
46. Ish kryetari turk, Turgut.

Kakuro

e lehtë

	17	7			16	17
13				17		
			23			
9			22			
		6				
	11				6	
		14				
	16	3				3
10				4		
11				3		

mesatare

	17	7				
11				29	11	
26						
		12				
					24	
		18				
						4
		16				
				9		

e vështirë

	16	3				
8						
			7		3	17
15					10	
					24	
		18				
	16	4				
21						17
						4
10				20		
				9		

KOHA e lirë për më të rinjtë

DETEKSIONI

Figurat e dhëna fshihen diku në fotografi. Ku?

akullorja brusha tenxherja copa e picës këpuca arushi

kërpudha buka doreza zilja peshqit

flamuri

brusha e dhëmbëve


shkop golfi

filxhani

varka


DALLIMET

Cilët janë 10 dallimet në fotografitë e mëposhtme!




LABIRINTI

Ndihmoni pulës të arrijë deri te zogu!




ZBULIMI

Ngjyrosni *trekëndëshat* që të zbuloni figurën!



VIZATIMI

Vizatoni duke i bashkuar pikat me radhë!



Sudoku

i lehtë

3		9		1				
		2		8				6
	7					4	9	
			1	6				3
	2		8		5			1
8				4	3			
	5	8						3
	3			1		9		
		9			8			2

mesatar

5								6
	3			7				5
	2	6			8	3	1	
		9	7		5			
	5		3		2			7
			4		1		5	
	4	3	1			2	8	
	1			2				4
2								5

i vështirë

	8	9				2	3	
								5
5		6	9		2	4		
		8	1	9		5		
			6		8			
		3		5	7	6		
		5	4		6	3		7
6								
	7	2				8	6	



KOHA e LIRË	TANTAL	KRYESUES I XHAMISË, HOXHË	RISK	TIFOZËT E KOSOVËS 1 SPECIALIST PËR VESHË	NEUTRON KËNGËTARJA TANITA	POLITIKANI ITALIAN, MARCELLO DEL	Q.A.	ME EROTIZËM	ZORO	KRYENË-ÇESITË
TIFOZËT E SHOIPËRISË 2										
FAMILJA ITALIANE, MËSHTER TË VIOLINAVE					PASUES, NDJEKËS IRISH BROS- KERS ASSOCIATION				AZOT TONE	
QË I TAKON ANATOMISË LLOJ KAFEJE ITALIANE						RADIUS RRËMBEN (USHQIMIN)		SPIKERE INDASE E BBC, SHEFALI NJËSI E V.J. E KAPACITETIT		
ILIR META			50 ROMAK KELVIN	TIFOZËT E TETOVËS 4 TIFOZËT E SHKUPIT 3						
LL		VEND NË KOSOVE SHUMËS				EMRI I VJETËR I IRLANËS PJESA E NJË TERËSIE				
I DIKURSHËM			GOSTIVAR		GODITJE NGA POSHTË (boks) RREGULLA VEPRIMIL KRITERIUME					



EXTENSIBLE KEY MANAGEMENT						LITËR PËRZIERËS				
ROMEN ROLAN						NJË PARAFJALË PËRËMËR VETOR				
LEXIM APO SHKRIM I NJË PJESE TË NJË AUTORI										
MORALE										
GRUMBULL AVUJSH FLET ME ZË TË LARTË						KALLAJ T.O.				
VEPRIM-TARITË ARTISTIKE										
BAZAT E PËRGJITH-SHME TË NJË SHKËNCË (pashq.)										



ROMEN ROLAN										
LEXIM APO SHKRIM I NJË PJESE TË NJË AUTORI										
MORALE										
GRUMBULL AVUJSH FLET ME ZË TË LARTË						KALLAJ T.O.				
VEPRIM-TARITË ARTISTIKE										
BAZAT E PËRGJITH-SHME TË NJË SHKËNCË (pashq.)										



EXTENSIBLE KEY MANAGEMENT						LITËR PËRZIERËS				
ROMEN ROLAN						NJË PARAFJALË PËRËMËR VETOR				
LEXIM APO SHKRIM I NJË PJESE TË NJË AUTORI										
MORALE										
GRUMBULL AVUJSH FLET ME ZË TË LARTË						KALLAJ T.O.				
VEPRIM-TARITË ARTISTIKE										
BAZAT E PËRGJITH-SHME TË NJË SHKËNCË (pashq.)										

SUDOKU "killer" SUDOKU ">" KENKEN ARUKONE NONGRAMI MOSBARAZ, TRANSFORM. I lehtë mesatar i vështirë

SKANDI

KRIPTOGRAMI

DALLIMET

PËR TË RINJTË

VIZATIMI

KAKURO

FJALËRRYQI KLASIK

168DHJET

Koha, e shtunë 6 janar, 2018

18 VITET E HUMBURA TË TREPÇËS



Gjatë këtyre 18 viteve, minatorët thonë se punuan në kushte mjaft të vështira. Moshë mesatare e minatorëve është 55-vjeç, e cila konsiderohet të jetë moshë e shtyrë për të bërë një punë në minierë. Rrogat aktuale të punëtorëve sillen nga 600 deri në 800 euro, varësisht përvojës dhe përgatitjes profesionale. Por, asnjë nga ata nuk ka sigurim shëndetësor apo jetësor

Cjiganti metalurgjik Trepça i ndarë në dy pjesë, në veriun e dominuar nga serbët dhe në jug me minatorë shqiptarë, për 18 vitet e pas luftës në Kosovë nuk arriti të rimëkëmbet. Funkcionalizimin e tij u tha se e pengoi statusi i pazgjdhur dhe ndarjes që ngjasonte edhe në vetë qytetin e Mitrovicës. Pas luftës, gjatë periudhës 2000-2004, miniera nuk ka funksionuar, por kishin filluar të bëhen përgatitjet e punishteve për prodhim, për të bërë të gatshme atë në vitin 2005, por me kapacitet minimal. Nga rreth 600 mijë tonë xehe në vit sa prodhonte miniera në vitet 1945 deri në periudhën e para vitit 1990, sot nga aty nxirren jo më shumë se 150 mijë tonë xehe. Edhe kapacitetet e saj humane janë zvogëluar përgjatë viteve, duke u reduktuar në më pak se 1000 punëtorë nga më shumë se 20.000, sa ishin të punësuar në këtë kombinat dikur. Në shkurt të vitit 2015 ndërmarrja Trepça, ishte rrezikuar të shkojë në likuidim, por Qeveria e Kosovës me hapa të shpejtë miratoi Ligjin për ndërmarrje publike, sipas të cilit Trepça nxirret nga administrimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe shndërrohet në ndërmarrje publike, të menaxhuar nga shteti.

TREPÇA, GJIGANTI QË PRET TË RINGJALLET

Ky vendim, në atë kohë ishte kundërshtuar nga partitë opozitare, të cilat kishin kërkuar që Trepça të trajtohet me një ligj të veçantë. Çështja e statusit të kombinatit ishte bërë edhe shkas i protestave të partive politike në opozitë në janar të vitit 2016, që u përshkuan me përplasje të ashpra ndërmjet protestuesve dhe forcave të rendit.

Po atë vit, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Trepçën, me të cilin u tha se gjiganti ekonomik do të rimëkëmbet dhe do të rikthehet në treg. Ligji e përcaktoi Qeverinë e Kosovës si pronare të 80 për qind të aksioneve të kombinatit. Vendimi i Qeverisë së Kosovës për kombina-



Nga rreth 600 mijë tonë xehe në vit sa prodhonte miniera në vitet 1945 deri në periudhën e para vitit 1990, sot nga aty nxirren jo më shumë se 150 mijë tonë xehe. Edhe kapacitetet e saj humane janë zvogëluar përgjatë viteve, duke u reduktuar në më pak se 1000 punëtorë nga më shumë se 20.000, sa ishin të punësuar në këtë kombinat dikur

tin Trepça kishte nxitur reagimin e Beogradi zyrtar, pasi ndërmarrjen Serbia e konsideron pjesë të saj. Ligji i miratuar për Trepçën, edhe pas një viti që nga miratimi, nuk arriti të zbatohet. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdin Lluca, ka thënë se presin se në gjashtë mujin e vitit 2018 të funksionalizohet kombinati Trepça. "Besoj që deri në muajin qershor do të kemi bordin, statutin regjistrimin e Trepçës si shoqëri aksionare, manaxhmentin e Trepçës si dhe vlerësimin e rezervave minerare, pasi që deri tani të dhënat për rezervat e Trepçës janë të viteve të 70-ta, e të cila nuk janë të mjaftueshme si të dhëna për investitorë të huaj, prandaj dhe duhet ta bëjmë një rivlerësim të atyre rezervave", ka thënë ministri Lluca.

I vetmi studim për të gjitha resurset natyrore të Kosovës, që është bërë në vitin 1992, pati vlerësuar se potenciali material i Trepçës mund të jetë 85 miliardë dollarë amerikanë. Institucionet e vendit u kritikuan nga përfaqësuesit e kombinatit Trepça dhe nga minatorët, se neglizhuan proceset që e bënin ligjin të zbatueshëm. Minatorët e Trepçës thonë për Radion Evropa e Lirë se procesi i neglizhuar që pa-

mundësoi zbatimin e Ligjit të miratuar për Trepçën, i krijoi humbje të mëdha ndërmarrjes. Shyqyri Sadiku, kryetar i sindikatës së Trepçës në një prononcim për Radion Evropa e Lirë flet për një gjendje jo të mirë në kombinatit Trepça. Ai thotë se prodhimi ka rënë në nivel shumë të ulët.

"Gjendja aktuale në Trepçë nuk është aspak e mirë dhe kjo për shumë arsye: si mosformimi i bordit mbikëqyrës, keqmenaxhimi, keqpërdorimet dhe mosdisiplina në punë. Vetëm në nëntë mujin e parë të këtij viti, kemi prodhim më pak për 30 për qind krahasuar me vitin paraprak. Nëse vazhdohet me vonesa në përzgjedhjen e bordit mbikëqyrës, Trepça do të shkojë drejt falimentimit", thotë Sadiku.

BOTA E RREZIKSH ME E MINATORËVE

Ai shton se për rënien e prodhimit në kombinatit Trepça janë të njoftuara të gjitha institucionet kompetente, por që nuk është ndërmarrë ndonjë hap konkret për daljen nga kjo situatë. Mosfunksionalizimi i Ligjit për Trepçën edhe sipas drejtorit të këtij kombinati, Ahmet Tmava, përveç rënies së prodhimit ka sjell vështirësi të

mëdha edhe të funksionimit si ndërmarrje. "Trepça është në fazën e mbijetesës me probleme të mëdha, por po shpresojmë që gjërat të lëvizin. Problemet shëndetësore të punëtorëve, mosha e shtyrë si dhe mungesa e investimeve, po sjell probleme. Për momentin statusi i Trepçës është i paqartë", thotë Tmava. Gjatë këtyre 18 viteve, minatorët thonë se punuan në kushte mjaft të vështira. Moshë mesatare e minatorëve është 55-vjeç, e cila konsiderohet të jetë moshë e shtyrë për të bërë një punë në minierë.

Rrogat aktuale të punëtorëve sillen nga 600 deri në 800 euro, varësisht përvojës dhe përgatitjes profesionale. Por, asnjë nga ata nuk ka sigurim shëndetësor apo jetësor. Isuf Beqiri, minator në minierën e Stantërgut, ku punon që prej vitit 1978, thotë për Radion Evropa e Lirë, se minatorët e Trepçës janë të harruar nga institucionet e Kosovës dhe se nuk po punohet asgjë në krijimin e kushteve më të mira për ta. "Nuk është bërë asgjë për neve minatorët. Një ligj që është bërë nuk ka filluar të zbatohet akoma. Gjendja e minatorëve është e vështirë, nuk kemi as sigurime shëndetësore, që nga pas lufta nuk kemi asgjë. Qeveria e Kosovës duhet të marrë masat për përmirësimin e kushteve të minatorëve", thekson Beqiri. Trepça sot, brenda Kosovës, përbëhet prej 41 njësisve të ndryshme, që grupohen kryesisht në tri komplekse të mëdha: në miniera me flotacione, në parkun industrial në Mitrovicë dhe në kompleksin e shkretoreve. Por, një pjesë e madhe e këtyre kapaciteteve janë të degraduara, për shkak të mungesës së mirëmbajtjes ose mungesës së investimeve, e madje edhe keqshfrytëzimit në të kaluarën. Nisur nga i gjithë ky degradim që i është bërë kombinatit gjatë këtyre viteve të pasluftës, ekspertë të fushës, thonë se gjigantit i duhet kohë të rimëkëmbet, por se kjo mund të arrihet me një punë të madhe dhe me njerëz profesionistë. (REL)



"Një veprim i tillë në pikëpyetje përkushtimin e Kosovës për sundimin e ligjit dhe rrezikon të gjitha të arriturat e Kosovës. Kjo i vënë interesat e individëve mbi interesat e shoqërisë kosovare. Ne e dënojmë një gjë të tillë, dhe kushdo që mbështetë një gjë të tillë, do të veprojë qëllimisht kundër partneritetit të Kosovës me vendet tona", thekson deklarata

Shtetet e Kuintit kanë shprehur shqetësimin e thellë me përpjekjet në Kuvendin e Kosovës për shfuqizimin e Gjykatës Speciale për krime luftime, përkatësisht Dhomave të Specializuara. "Jemi thellësisht të shqetësuar me përpjekjet e vazhdueshme për të zhvlerësuar punën e Dhomave të Specializuara", thuhet në deklaratën e përbashkët. Aty shprehet shqetësimi edhe në lidhje me vendimin e Presidentit të Kosovës për të falur tre të dënuar për vrasje, në të ashtuquajturin "rasti i familjes Hajra". Ata ishin shpallur fajtorë nga Gjykata e Qarkut dhe ajo Supreme për vrasjen e pesë anëtarëve të familjes Hajra në vitin 2001 dhe ishin dënuar me nga 30 vjet burgim. "Dhomat e Specializuara, në veçanti janë pjesë e rëndësishme e përkushtimit të Kosovës për sundim të ligjit dhe angazhimit të Kosovës për të adresuar krimet e kryera në territorin e saj", thuhet në deklaratë, e cila u është shpërnda mediave nga Ambasada Amerikane në Prishtinë. Aty rikujtohet se vendet e Kuintit kanë qenë prej kohësh miq të vërtetë të Kosovës, përfshirë këtu edhe në kohërat më të vështira. "Që nga mbështetja jonë për ndërhyrjen e NATO-s, sakrificimin e ushtarëve tanë në Kosovë, njohjen e menjëhershme të pavarësisë së Kosovës dhe mbështetjen tonë të vazhdueshme në zhvillimin tuaj, ne kemi punuar shumë për të mbështetur vendin tuaj. Suksesi juaj është në interesin tonë. Megjithatë, ne do të këmbëngulim gjithmonë që Kosova të mbështesë drejtësinë", vijon deklarata.

Aty potencohet se nuk ka asnjë arsye për të penguar punën e Dhomave të Specializuara dhe ftohen udhëheqësit e institucioneve të Kosovës, ata të partive dhe deputetët, të heqin dorë nga çdo tentim për të shfuqizuar apo ri-negocuar çfarëdo pjesë të Ligjit për Dhomat e Specializuara. "Një veprim i tillë në pikëpyetje përkushtimin e Kosovës për sundimin e ligjit dhe rrezikon të

HIQNI DORË NGA SHFUQIZIMI I GJYKATËS SPECIALE



NATALYA APOSTOLOVA

Këto institucione të drejtësisë ndërkombëtare do të merren me individët që kanë kryer krime. Nuk ka asnjë justifikim për askënd që përpiket të parandalojë hetimin e krimeve, ndëshkimin e autorëve duke u siguruar kështu viktimave së paku pak qetësi

gjitha të arriturat e Kosovës. Kjo i vënë interesat e individëve mbi interesat e shoqërisë kosovare. Ne e dënojmë një gjë të tillë, dhe kushdo që mbështetë një gjë të tillë, do të veprojë qëllimisht kundër partneritetit të Kosovës me vendet tona", thekson deklarata. "Ftojme të gjithë liderët e Kosovës dhe deputetët e Kuvendit të Kosovës të ngrisin zërin kundër kësaj iniciative dhe me sinjeritet të plotë të informojnë qytetarët e Kosovës për pasojat e rënda negative, përfshirë këtu edhe procesin e integritimit

ndërkombëtarë dhe Euro-Atlantik të Kosovës, nëse Kosova vazhdon në këtë mënyrë. Në të njëjtën kohë, presim që të gjitha shtetet të ndjekin penalisht ose të bashkëpunojnë në plotni, në gjykimin e krimeve të supozuara, të kryera në Kosovë", potencohet në këtë qëndrim të pesëshes së madhe, të njohur si Kuint. "Krijimi i Dhomave të Specializuara ishte mënyra e vetme për Kosovën të dëshmojë përkushtimin e saj për drejtësi dhe sundim të ligjit, dhe të vazhdojë të pranojë mbështetjen ndërkombëtare. Me ndihmën tonë, Kosova ka shënuar përparim në shtatë vitet e fundit për arsye të përkushtimit të saj për drejtësi ndërkombëtare. Vendimi i Kuvendit në vitin 2015 për të krijuar Dhomat e Specializuara ishte shenjë e qartë se Kosova refuzoi kulturën e mosndëshkimit", thuhet në deklaratë.

"Nuk kishte asnjë marrëveshje ndërmjet komunitetit ndërkombëtarë dhe Kosovës lidhur me krijimin e Dhomave të Specializuara", përfundon deklarata. Në shtete e Kuintit, bëjnë pjesë Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britania e Madhe, Gjermania, Franca dhe Italia. Reagimi i tyre ka pasuar nismën e një grupi të deputetëve të Kosovës për të shfuqizuar Gjykatën

Speciale për krime luftime. Kjo nismë nuk është kundërshtuar as nga liderët e institucioneve qendrore. Gjykata Speciale për krime luftime në Kosovë pritet të hetojë krimet e pretenduara të pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, që siç thuhet, "i kanë kryer ndaj pjesëtarëve të komuniteteve pakicë dhe kundërshtarëve politikë nga viti 1998 e deri në fund të vitit 2000", siç e ka përshkruar në raportin e tij për Këshillin Evropian senatori Dick Marty.

POROSIA AMERIKANE PËR HARADINAJN

Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kanë përcjellë alarmin tek autoritetet e Kosovës se mund të vihet në funksion "Plani B" për formimin e Gjykatës Speciale, i cili ishte përmendur edhe dy vjet më parë, kur autoritetet refuzonin të jepnin votën pro saj. Mesazhi është përcjellë nga ushtruesi i detyrës së ambasadorit amerikan në Prishtinë, Stephen Banks. Burime të gazetës në Zyrën e kryeministrit kanë treguar, të enjten, se Banks ka zhvilluar këtë javë disa takime me krerët e institucioneve, të cilëve ua ka rikujtuar pasojat që do t'i pësonte Kosova nga shfuqizimi i Ligjit për Specialen. "Ushtruesi i detyrës së

ambasadorit amerikan në Prishtinë, Banks, ka takuar dje në mesditë kryeministrin Haradinaj, të cilin ia ka bërë të qartë pasojat që do të kishte shfuqizimi i Ligjit për Gjykatën Speciale. Troç i ka thënë se, në Këshillin e Sigurimit, Shtetet e Bashkuara nuk do të bllokojnë asnjë iniciativë të Rosisë që lidhet me krijimin e një gjykate të ngjashme", ka thënë ky burim.

SHFUQIZIMI I SPECIALES VË NË PIKËPYETJE BESUESHMËRINË E KOSOVËS

Shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian në Prishtinë, Natalya Apostolova, ka deklaruar për gazetën "Zëri" se iniciativa e fundit e disa deputetëve për ta shfuqizuar Ligjin mbi Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorisë Speciale ishte një veprim shumë i rrezikshëm, i cili minonte jo vetëm sundimin e ligjit, por edhe besueshmërinë e Kosovës si partnere e Bashkimit Evropian (BE). Apostolova ka bërë të ditur se viteve të fundit Kosova ka bërë progres si në aspektin vendor, ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Prandaj, siç ka thënë ajo, janë shikuar me optimizëm marrëdhëniet Kosovë - BE, duke e përsëritur vazhdimisht në nivelet më të larta që vendi ka një të ardhme të qartë evropiane. E para e Bashkimit Evropian në Prishtinë ka sqaruar për gazetën "Zëri" se themelimi i Dhomave të Specializuara dhe i Prokurorisë Speciale është një detyrim ndërkombëtar për Kosovën dhe këto të fundit nuk targetojnë vende, komunitete apo organizata specifike. "Këto institucione të drejtësisë ndërkombëtare do të merren me individët që kanë kryer krime. Nuk ka asnjë justifikim për askënd që përpiket të parandalojë hetimin e krimeve, ndëshkimin e autorëve duke u siguruar kështu viktimave së paku pak qetësi", ka potencuar Apostolova për "Zërin".

VËSHTIRËSITË QË KALOI BALLKANI NË 2017

Duke komentuar vitin që lamë pas, shefja e diplomacisë së BE, Federica Mogherini thekson se 2017-a ishte një vit i vitit i vështirë për botën, por jo pa momente të mira. Mogherini shprehet se Ballkani kaloi një vit jo të lehtë. Sipas zyrtares së lartë të Unionit, rajoni kaloi edhe kriza të thella politike. Mogherini thekson se vendimet e guximshme dhe puna e madhe e gjithsecilit bënë të mundur zhbllokimin e tyre. "Nuk ishte një vit i lehtë për Ballkanin. I vizitova të gjashtë kryeqytetet e rajonit në disa prej momenteve më të vështira, në disa raste gjatë krizave të



thella politike. Sot, falë vendimeve të guximshme dhe punës së madhe që kryem së bashku, këtyre krizave iu është dhënë një drejtim dhe shumica janë zgjidhur". Shefja e diplomacisë së BE-së është optimiste për 2018-n.

"Rruga drejt reformave ka rifilluar (pavarësisht se ka shumë punë për të bërë) dhe busulla e integritimit të Bashkimit Evropian po tregon rrugën. Viti 2018 do të jetë një vit thelbësor për konsolidimin dhe bërjen e këtij rrugëtimit të pakthyesëm. Do të sillte rezultate të rëndësishme jo vetëm për rajonin por edhe për Evropën në tërësi", thekson ajo.



Tri vite burg për Sakashvilin

Cjykata e Tbilisit e ka shpallur të fajshëm ish presidentin gjeorgjian, Mikheil Saakashvili për abuzim të pushtetit lidhur me një vrasje të vitit 2006, duke e dënua në mungesë me tri vite burgim. Gjyqtari, Giorgi Arevadze, ka shpallur sot vendimin kundër Saakashvilit, i cili ishte president i Gjeorgjisë nga viti 2004 deri më 2013. Gjykata e ka gjetur fajtor Saakashvilin për abuzim të fuqisë së tij si president, duke tentuar të fshehtë të dhëna për vrasjen e punëtorit të bankës, Sandro Girgvliani, dhe faljen e katër burrave që ishin të dënua për vrasje. Girgvliani, ishte udhëheqës i departamentit për të huaj në Bankën e Bashkuar Gjeorgjiane. Ai ishte gjetur i vdekur më 2006 jashtë Tbilisit me shumë plagë, pasi ishte parë teksa ishte fjalosur në një lokal me zyrtarë të ministrisë së Brendshme. Vrasja e Girgvlianit dhe mosgatishmëria e autoriteteve për të hetuar vdekjen e tij, ka rezultuar me kritikizëm të ashpër në qeverinë e Saakashvilit. Saakashvili që tani banon në Ukrainë, ka kundërshtuar vazhdimisht akuzat kundër tij, duke i cilësuar si të motivuara politikisht. Më herët Ukraina ka refuzuar kërkesat e autoriteteve të Tbilisit për të ekstraduar Saakashvilin në Gjeorgji.



ÇFARË DUAN

DEMONSTRUESIT E IRANIT?

Shteti iranian i deklaroi protestat të përfunduara. Por megjithatë njerëzit vazhdojnë të demonstrojnë në rrugë. Zhgënjimi i nxit ata për protestë, por qëllimet e tyre janë të paqarta

Pas një jave protestash të ashpra kundër qeverisë udhëheqja iraniane mobilizoi të mërkurën (03.01.) mbështetësit e vet. Ndërsa mediat shtetërore heshtën për protestat e kritikëve ato transmetuan marshimin e përkrahësve të qeverisë në të gjitha kanalet. Komentarët e përshkruanin marshimin si "mbështetje e popullit për qeverinë e në radhë të parë për udhëheqësin fetar Ali Chamenei personalisht". Pak pas kësaj gjeneral-majori Mohammad Ali Jafari, komandant i Gardës së fuqishme të Revolucionit, deklaroi fundin e protestave antiqeveritare. Por ato përfunduan vetëm derisa ra errësira. Gjatë natës (04.01) sërish pati protesta të pjeshme në provinca, pavarësisht përfundimit të trupave të policisë. Përdorues anonimë të rrjeteve sociale u dërgonin video gazetarëve nga këto protesta. Por vërtetësia e videove nuk mund të verifikohet.

"Çfarë duan demonstruesit? Nuk e kam idenë!", thotë Mohmudi nga Teheran në intervistë me telefon për DW. "Unë nuk i mbështes ata. Por ajo që kanë arritur është impresionuese. Çmimi i vezëve është ulur. A nuk është kjo më

shumë, se sa ka arritur opozita e orientuar nga reformat në këto 20 vitet e fundit?". 31-vjeçari Mahmud shprehet plot cinizëm. Ai doktoron në fushën e fizikës. Pas studimeve ai do të largohet nga vendi. Shpresa që mund të përmirësohet gjë, atij i ka humbur prej kohësh. Mahmudi ka qenë mbështetës i "Lëvizjes së Gjellbër" në vitin 2009. Gjatë protestave atëherë kundër zgjedhjeve të diskutueshme presidenciale atë e rrahën disa herë dhe e kanë arrestuar. "Atëherë ne e dinim se ç'donim. Ne mbështesnim kandidatin tonë Mir Hossein Musaui. Ne donim që vota jonë të kishte vlerë. Prej kësaj u krijua një

lëvizje. Njerëzit që kanë dalë në rrugë ditët e fundit kanë protestuar kundër gjithçkaje, por ata nuk e dinë se për çfarë". Protestat nisën të enjten e kaluar (28.12.) në Mashad në veri të vendit. Shkaku ishin çmimet e vezëve. Ato u rritën me rreth 70 për qind. Njëkohësisht u komunikua plani i qeverisë për rritjen me 50 për qind të çmimit të benzinës. Fillimisht protesta u drejtua kundër politikës ekonomike të qeverisë, por nisi të marrë gjithnjë e më shumë trajtën e protestës kritike ndaj sistemit. Shpejt situata u përshkallëzua dhe protestat u bënë gjithnjë e më të dhunshme. Nuk është e qartë se

kush e nisi dhunën. Sipas të dhënave zyrtare ditët e fundit gjetën vdekjen të paktën 22 vetë. Në mbarë vendin u arrestuan mbi 1000 demonstrues. Moshja mesatare e demonstruesve është nën 25 vjeç. "Kemi të bëjmë me të rinj që vijnë nga pjesë të vendit të lëna pas dore", thotë për DW politologu Sadegh Zibakalam nga Universiteti i Teheranit. "Ata janë të zhgënjyer prej gjithçkaje. Shumë prej tyre votuan para shtatë muajsh për presidentin Hasan Rohani. Ai premtoi shumë, por deri tani nuk ka mundur të realizojë asgjë. Zhgënjimi e ka kthyer pendulin në kahun e kundërt".

NJË BREZ QË NUK KA MË BESIM TEK ASKUSH E ASGJË

Rohani u pati premtuar zgjedhësve vende të reja pune. Ai shpresonte që me shfuqizimin e sanksioneve ndërkombëtare pas marrëveshjes atomike, ekonomia do të merrte hov. Por kjo nuk ndodhi. Papunësia që nga viti 2016 është në nivelin 12 për qind. Irani ka një popullsi të re nën 25 vjeç.

Mosha mesatare është 31 vjeç. Gazeta "Iran", që botohet nga agjencia shtetërore e lajmeve IRNA, shkruan, se qytetet me papunësinë më të

lartë janë prekur më shumë nga protestat. "Shteti përballet me një brez, që nuk beson më në asgjë e tek askush. Ata nuk kanë më besim as tek qeveria, as të institucionet fetare e as tek opozita e orientuar nga reformat", thotë politologu Zibakalam. "Këta të rinj nuk kanë më durim. Ne duhet t'i marrim seriozisht problemet e tyre. Pakënaqësia e tyre është një sfidë e madhe, që ne nuk duhet ta nënvleftësojmë".

KONFLIKTI NË ETIOPI MUND T'I NDAJË 14 MIJË FËMIJË NGA FAMILJET E TYRE

Gjatë vitit të kaluar, përplasjet mes dy komuniteteve kufitare në rajon kanë lënë qindra të vdekur ndërsa dhjetëra mijëra janë detyruar të lëshojnë shtëpitë e tyre



Fondi për Fëmijë i Kombeve të Bashkuara (UNICEF) paralajmëroi se konflikti përgjatë kufijve të rajonit Oromia të Etiopisë dhe Somali-

së mund t'i ndajë mbi 14 mijë fëmijë nga familjet e tyre. Gjatë vitit të kaluar, përplasjet mes dy komuniteteve kufitare në rajon kanë

lënë qindra të vdekur ndërsa dhjetëra mijëra janë detyruar të lëshojnë shtëpitë e tyre. "Ka të dhëna se nga 84.659 të zhvendosur

brenda vendit, fëmijë të moshës shkollare aktualisht nuk kanë qasje në asnjë shërbim arsimor në rajonet Oromia dhe Somali", tha UNICEF në një deklaratë me shkrim, duke shtuar se 120 mijë fëmijë nën moshën 5 vjeçare dhe 20 mijë gra shtatzëna kanë nevojë për shërbim urgjent të të ushqyerit.

UNICEF tha se nevojiten 2.9 milionë dollarë për edukimin e fëmijëve të moshës shkollare me arsim fillor, ndërsa një shtesë prej 2.9 milionë dollarë të tjera nevojiten për vaksina, barna emergjente, logjistikë dhe mbështetje teknike shëndetësore për të zhvendosurit e

brendshëm. Për më tepër, 2.6 milionë dollarë nevojiten për nevojat e të zhvendosurve të moshës nën 5 vjeç dhe 2.400 grave shtatzëna. "Deri në dhjetor të vitit 2017, situata e përgjithshme e sigurisë përgjatë kufirit të këtyre dy rajoneve mbetet e paqëndrueshme dhe e paparashikueshme", theksoi UNICEF. Gjatë dy viteve të fundit, Etiopia është sfiduar nga protestat vdekjeprurëse anti-qeveritare në rajonet më të mëdha Oromia dhe Amhara, përveç përleshjeve etnike që u ndezën përgjatë zonave kufitare të rajoneve Oromia dhe Somali.

Ish-kapiteni i Teutës e ka gjetur zgjidhjen, pasi ai mund të luaj në ato kampionate të cilat fillojnë në shkurt ose mars. Një nga këto kampionate sipas "panorama-sport" është ai i Suedisë, ku raportohet se dy ekipe në këtë vend janë të interesuara për Lenën

Shkup, 5 janar - Nijaz Lena zgjodhi të largohej nga Teuta para disa ditësh, edhe pse u afrua në klub vetëm disa muaj më parë. Mesfushori nga Struga ka luajtur tashmë në dy ekipe për këtë sezon, pasi luajti në kualifikueset e Ligës së Kampionëve me Kukësin dhe nuk mund të luaj me një ekip të tretë deri në fund të sezonit. Por duket se ish-kapiteni i Teutës e ka gjetur zgjidhjen, pasi ai mund të luaj në ato kampionate të cilat fillojnë në shkurt ose mars. Një nga këto kampionate sipas "panorama-sport" është ai i Suedisë, ku raportohet se dy ekipe në këtë vend janë të interesuara për Lenën. Goteborg dhe Gais janë dy skuadrat që kanë kontaktuar futbollistin strugan dhe bëhet fjalë për dy ekipe me emër në futbollin suedez. Cekim,

E ARDHMJA E ISH-KAPITENIT TË TEUTËS LARG SHQIPËRISË

LENËN E KËRKUJNË DY EKIPE SUEDEZE



pas prishjes së marrëveshjes me Teutën ishin të shumta e kampionatit shqiptar që kërkuan shërbimet e mesfushorit, por vazhdimësia e tij në Superiore rrezikohej nga rregullorja. Në Shqipëri e vetmja mundësi për të është rikthimi te

ekipi i Kukësit, por tashmë verilindorët kanë një trajner të ri dhe nuk dihet nëse ai është i interesuar apo jo për shërbimet e tij.

Nijaz Lena me Teutën gjatë stinorit vjeshtor nga gjithsej 16 ndeshje, luajti në 14 prej tyre, edhe atë

në të gjitha si titullarë, duke realizuar edhe dy gola. Derisa, gjatë karrierës së tij të deritanishme Lena ka luajtur për klubet si Make-donija Gj.P., Flamurtari nga Vlora, në dy herë te Teuta nga Durrësi dhe Kukësi.



Klubi italian i fiksuar pas Memushajt

Ledjan Memushaj po përfillet gjithmonë e më shumë për një kalim të mundshëm tek Bari. Është "Gazzetta dello Sport" që shkruan se ekipi i Serisë B që mban vendin e katërt në klasifikim, e kërkon mesfushorin vlonjat, si një përforsim për kualitetin e skuadrës. Për Memushajn, Bari është gati të ofrojë shkëmbimin me mbrojtësin Arkimede Morleo. Mes drejtuesve të Beneventos dhe ekipit të Barit pritet një takim në javën e ardhshme. Tek Bari, Memushaj do të gjejë edhe një mesfushor tjetër të Kombëtares, Migjen Bashën.



Mesfushori i Kombëtares shqiptare, Eros Grezda, ka tërhequr vëmendjen e disa klubeve evropiane, falë paraqitjeve të mira me klubin e tij, Osijekun, dhe Kombëtare. Mediat kroate e shohin të

Grezda mund të largohet nga Osijeku

Greza mund të largohet nga Osijeku

ardhmen e mesfushorit drejt kampionatit italian. Ato aludojnë se Italia është destinacioni më i mundshëm për Grezdën, por burimi nuk përmend emër të ekipit të mundshëm ku mund të kalojë Grezda. Nëse ofrohet vlera e kartonit të tij, atëherë drejtuesit e

klubit janë të gatshëm ta lënë të lirë lojtarin. Kohë më parë u përfol për një interesim të Xhenoas dhe Lacios për të. Për momentin nuk ka asgjë zyrtare, por gjasat janë që në ditët në vazhdim situata të bëhet akoma më konkrete

Roshi rikthehet në Kroaci



Mesfushori i Kombëtares Shqiptare, Odise Roshi, po luan sezonin e dytë te ekipi rus i Terek Groznit. Por me ardhjen e merkatos së janarit kanë nisur edhe zërat për një largim të mundshëm të fierakut nga ky klub. Lojtari mund të rikthehet të luajë përsëri në Kroaci, aty ku para dy sezonesh luante te Rjeka, por kësaj radhe te rivalët e tyre, Dinamo e Zagrebit. Raportohet se gjigantët e Kroacisë kanë pasur interesim për lojtarin.

Edhe pse nuk është ende e sigurt nëse do të largohet apo jo, lojtari preferon që të luajë në një kampionat të fortë nëse largohet nga skuadra ruse.

Seleksionuesi i ri mësohet në pranverë

Presidenti i FFK-së, Fadil Vokrri ka folur edhe njëherë për pardshtësin e përzgjedhësit të Përfaqësueses së Kosovës, Albert Bunjaki. Ai ka theksuar se është në kontakt me disa personalitete nga komuniteti i trajnerëve dhe beson se deri në pranverë do të vijë zgjidhja e duhur.

"Pas ndarjes me mirëkuptim nga përzgjedhësi Albert Bunjaku, i cili vërtet ka bërë një punë të madhe në një kohë të vështirë për tubimin e futbollistëve si krijimin e skeletit të Kombëtares, unë kam filluar të kontaktojë shumë personalitete nga komuniteti i trajnerëve, por ende nuk mund ta them asnjë emër konkret. Unë jam i inte-



resuar shumë dhe, besoj se, në pranverën e ardhshme do ta kemi një përzgjedhës që do të i përbush kriteret tona, konform objektivave tona", ka thënë Vokrri për "Telegrafin". Kosovën në ndeshjen e fundit miqësore të fituar ndaj Letonisë e drejtoi ushtruesi i detyrës i seleksionuesit, Muharrem Sahiti.

PSZH KA BËRË GATI "BOMBËN" E RADHËS



Klubi parisien kthehet përsëri nga njëra prej dëshirave të mëdha të pronarëve të tij. Sheikët, që financojnë gjigandët e kryeqytetit francez, pas rekrutimit të Neymar dhe Mbappe, verën e kaluar, janë të bindur se mund të arrijnë edhe te pesë herë fituesi i "Topit të Artë". Ata, veç parave, janë në gjendje t'i ofrojnë CR7 një projekt sportiv që, sipas tyre, nuk duhet ta ketë zili Real Madridin

Paris Sen-Zhermeni kthen vëmendjen nga Kristiano Ronaldo. Dje bëri bujë lajmi i mediave iberike se ylli i madh i Real Madridit ka marrë tri oferta të rëndësishme, ndërkohë që, "El Confidencial", ka dal me emra të përveçëm, duke zbuluar njërin nga skuadrat e marrosura pas portugezit. Dhe Real Madridi ka pse të shqetësohet, sepse në lojë është PSZH-ja, që verën e kaluar arriti t'i rrëmbejë yllin brazilian, për një shumë

rekord të të gjitha kohërave, Neymar. Klubi parisien kthehet përsëri nga njëra prej dëshirave të mëdha të pronarëve të tij. Sheikët, që financojnë gjigandët e kryeqytetit francez, pas rekrutimit të Neymar dhe Mbappe, verën e kaluar, janë të bindur se mund të arrijnë edhe te pesë herë fituesi i "Topit të Artë". Ata, veç parave, janë në gjendje t'i ofrojnë CR7 një projekt sportiv që, sipas tyre, nuk duhet ta ketë zili Real Madridin.

Oferta parisienë ka pasur pasoja në politikën e shitjeve të klubit francez. Duke pasur parasysh shpenzimet e bëra verën e kaluar dhe tjetra (kur nënshkrimi i Mbappe do të jetë efektiv), PSG urgjentisht duhet të rimbursojë 70 milionë euro për të përmbushur "fair-play financiar" të UEFA-s, i cili do të shpjegonte nxitimin e entitetit francez në shitjen e disa prej lojtarëve aktualë. Sidoqoftë, rasti i Kristiano Ronaldos do të ki-

shte pak të bëjë me Neymarin. Për fillestarët, klauzola e Kristiano Ronaldos te Real Madridi është shumë më e lartë se ajo e brazilianit në Barcelonë: 1000 milionë euro për 222 milionë euro. Shifra është e papranueshme për çdo ekip, prandaj një largim i ngjashëm është përjashtuar. Duhet të ketë negociata, edhe pse klubi i bardhë nuk është në favor të lejimit të largimit të yllit më të madh.



Më në fund lajm i mirë nga neurologu i Shumaherit

Një nga mjekët e njohur që është pjesë e klinikës ku po trajtohet shtatë herë kampioni i botës në Formula 1, Mihael Shumaher, e ka thyer heshtjen dhe ka dhënë një lajm të mirë. "Nuk duhet që t'i humbasim shpresat, pasi gjendja e tij po shkon drejt përmirësimit. Në bazë të një studimi, 50 për qind të rasteve, pacientë si Shumaher që kanë qëndruar për një kohë të gjatë në koma e kanë rifituar ndërgjegjen dhe kanë reaguar. Ajo që duhet të bëjmë është të jemi të duruar", ka thënë Oberman, një ndër neurologët më të mirë në botë. Gjermani ka katër vite prej kur është në koma, pas një aksidenti që pësoi në Alpe derisa po skijonte. Kjo është deklarata e parë që një mjek i ish-pilotin e Formula 1, flet hapur për gjendjen shëndetësore të pilotit.

Tevez në bisedime për t'u larguar nga Kina

Karlos Tevez është në bisedime me Shangai Shenhua për ta siguruar një lirim të hershem nga kontrata në mënyrë që të rikthehet te Boca Juniors, raporton "Youth Daily". Argjentinasi 33-vjeçar dështoi të rikthehej brenda afatit të caktuar në stërvitje parasezonale me skuadrën këtë të enjte në Marbella, prandaj Shenhua tashmë është e gatshme ta largojë atë në drejtim të Argjentinës. Megjithatë, Shenhua nuk dëshiron t'ia bëjë Tevezin një pagesë të madhe, gjersa bisedimet për një marrëveshje të re vazhdojnë, në mënyrë që t'i lejohet ish-sulmuesit të Mançester Junajted të largohet nga Kina.



Uilliams tërhiqet nga "Australian Open"

Të gjithë prisnin me padurim rikthimin në fushë të tenistes amerikane Serena Uilliams, që në shtator të vitit të kaluar u bë nënë, por ish-numri 1 në botë ka vendosur të mos luajë në grand slemën e "Australian Open". Për pasojë, motra e vogël Uilliams nuk do ta mbrojë titullin e fituar një vit më parë. Edhe pse Serena luajti në një turne "show" në Abu Dabi më 28 dhjetor, ajo ende nuk është gati për të përballuar një turne të madh. Vetë

Serena Uilliams ka pranuar se nuk është në kushtet optimale për të zhvilluar një turne të tillë të vështirë. "Pas ndeshjes në Abu Dabi kuptova se nuk jam gati edhe pse gradualisht po i afrohem formës time. Por nuk jam 100% dhe nuk dua të luaj sa për të kaluar radhën. E ndiej që jam gati për të luajtur, por nuk dua vetëm të luaj, dua të fitoj ndaj më duhet ende edhe pak kohë për ta realizuar këtë gjë, tha Serena Uilliams.

Nuk i pëlqejnë Zidanit

Hames Rodriguez shkëlqeu në sezonin e parë me Karlo Ancelotin, por iu vështirësua gjithçka me ardhjen e Rafa Benitez, edhe më shumë me atë të Zinedin Zidane, për çka edhe u detyrua të largohet nga "Santiago Bernabeu" gjatë verës që lamë pas. James tani mendon se largimi i tij nga Real Madridi ka të bëjë me trajnerin Zinedin Zidan, që nuk i ka pëlqyer si lojtar, jo për shkak të paraqitjeve, pasi kolumbiani

mendon se ka luajtur mirë sa herë ka zbritur në fushë. "Mendoj trajnerët kanë preferencat e tyre dhe mendoj se nuk isha një nga preferencat e Zidan, pavarësisht se luaja mirë, shënoja gola dhe dhuroja asistime. Siç thash më parë, të gjithë kanë preferencat dhe duhet t'i respektojmë" u shpreh ai. "Nuk e kam ndërmend të kthehem. Ndihehem mirë dhe dua të fitoj gjithçka me BaJernin", deklaroi Hames.





REALI OFRON BENZEMAN PËR TRANSFERIMIN E IKARDIT

Pretendohet se Real Madridi mund t'i ofrojë Interit shërbimet e Karim Benzemas si pjesë e ndonjë marrëveshjeje për Mauro Icardin, por ka më shumë gjasa që sulmuesi të rinovojë kontratën e tij. Klubi spanjoll ka qenë i lidhur ngushtë me sulmuesin në ditët e fundit, ndërsa "L'Equipe" raportoi dje se një lëvizje e mundshme ishte diskutuar nga klubi dhe trajneri Zinedin Zidan. "Gaz-

zetta dello Sport" në edicionin e sotëm thekson se klauzola e lirim të Icardit prej 110 milionë eurosh nuk është e vlefshme në janar, kështu që ai do të kushtonte edhe më shumë nëse Los Merengues do donin të bënin një lëvizje këtë muaj. Kapiteni i Nerazzurrëve nuk është i lidhur me Ligën e Kampionëve, kështu që ai do mund të luajë për Madridin në atë garë nëse transferohet në

"Bernabeu". Gazeta spekulon se kampionët spanjollë madje mund të ofrojnë Benzeman në këmbim, duke i dhënë menjëherë një zëvendësimi klubit italian. Pavarësisht nga kjo, "Gazzetta dello Sport" gjithashtu vë në dukje se situata financiare e "Fair Play"-it e Interit nuk do të thotë se ata duhet të shesin lojtarin e tyre kryesor. Përveç kësaj, Icardi gjithmonë ka pohuar se dëshiron të

qëndrojë me klubin, kështu që një veprim i janarit duket pothuajse i pamundur. Në të vërtetë, një takim është planifikuar midis gruas dhe agjentes së tij, Vanda, dhe avokatëve të klubit për muajin shkurt për të ripërtërirë kontratën e argjentinasi. Icardi do t'i jepej një rritje pagash, ndërsa klubi do të ngrite edhe klauzolën e lirim të tij edhe më shumë se 110 milionë euro.

Klubi spanjoll ka qenë i lidhur ngushtë me sulmuesin në ditët e fundit, ndërsa "L'Equipe" raportoi dje se një lëvizje e mundshme ishte diskutuar nga klubi dhe trajneri Zinedin Zidan



Sirena kineze për Nainggolanin

Raxha Nainggolan mund të largohet nga Roma pas problemeve të fundit, dhe është raportuar se Guangzhou Evergrande janë të interesuar të nënshkruajnë me atë. Mesfushori belg publikoi një video të vetës së tij në "Instagram" duke pirë duhan, alkool dhe duke sharë në prag të Vitit të Ri, duke krijuar pompozitet te Roma. Klubi romak nuk mendo shumë dhe thuhet se ia shqiptoi atij një gjobë prej 100 mijë eurosh. Gjithashtu pritet që ai të dënohet edhe për ndeshjen e kësaj fundjave ndaj Atalantas, pasi klubi kërkon të vendosë shembull për lojtarët tjerë. Sipas gazetës "Gazzetta dello Sport", ka gjithashtu një mundësi të pakët që Nainggolan mund të shitet. Klubi i Guangzhou Evergrande mendohet të jetë i gatshëm të ofrojë 40 milionë euro për të sjellë belgun në Kinë dhe ata kanë vend në skuadrën e tyre për një lojtar të huaj. Megjithatë, çdo marrëveshje do të ishte e vështirë, pasi Nainggolan nuk mendohet të jetë i interesuar për një lëvizje në Kinë dhe ka refuzuar Çellsin, Interin dhe Juventusin në të kaluarën. Përveç kësaj, skuadra romake do të dëshironte një çmim më të lartë transferimi për një nga lojtarët e tyre kryesorë, kështu që klubi i SuperLigës Kineze do të duhet të ofrojë së paku 50 milionë euro.




Milani synon suedezin Augustinsson

Milani nuk do të bëjë lëvizje të mëdha në merkaton e janarit. Fushata faraonike e nënshkrimeve të verës ka lënë shenjën e saj jo vetëm në aspektin ekonomik. Sidoqoftë, ndonjë përforsim për Cattuson mund të vijë, gjithsesi. Sipas "Corriere dello Sport", në orët e fundit ka dalë në skenë një profil surprizë: në Milanello janë të interesuar për Ludvig Augustinsson, mbrojtësin e majtë të datëlindjes 1994, pjesë e Verder Bremen dhe kohët e fundit "xhelat" i kombëtares së Italisë me Suedinë e tij. Augustinsson mund të ofrojë fleksibilitet të madh, pasi mund të vendoset edhe në një pozicion më ofensivë. Një lloj i përgatitjes së lamtumirës për Antonelli, edhe pse ky lojtar nuk mund të jetë i vetmi, që do të largohet nga kuqezinjët. Pranë lamtumirës duket edhe Lokatelli (i ndjekur nga Fiorentina dhe Torino), si dhe Jose Mauri, Gabriel, Paletta dhe Gustavo Gomez. Këta të fundit lidhen me një kthim te Boka Juniors.

Barcelona kryeson garën për Grizmanin

Ashtu si raporton "Le10Sport", gjigantët e La Liga, Barcelona, janë shumë pranë arritjes së marrëveshjes me sulmuesin e Atletiko Madridin, Antoni Grizman, prej kohësh objektiv i Mançester Junajtedit në merkato. "Telenovela", për të ardhmen e sulmuesit francez, ka nisur që në verën e kaluar, kur Hoze Murinjo e etiketoi si përforsim i duhur për "djajtë", por marrëveshja nuk u arrit sepse "embargo" që FIFA i vuri Atletiko Madridit në merkato i detyroi spanjollët të "blindonin" 26 vjeçarin. Në janar, kur Atletiko federoi dy sulmues të rinj Diego Kosta dhe Vietto, Grizman ka nisur të mendojë për të ardhmen larg "Wanda Metropolitan". Junajtedi nuk ka hequr dorë dhe do të paraqesë një tjetër ofertë për futbollistin, sapo



të nis viti i ri kalendarik, por sipas "Le10Sport", britanikët kanë humbur terren në garën për Grizman, sepse futbollisti do të pranonte me kënaqësi më të madhe të qëndronte në La Liga, aq më tepër me Barcelonën. Klubi katalanas do të nis së shpejti kontaktet me futbollistin, që do të kompletonte

"tredhëmbëshin" me Messi dhe Suarez, por mbetet për t'u parë vendimi i Atletikos. Klubi i Simeones do të ishte "pro" kalimit të lojtarit në Premier Ligë, në vend të që shkonte te rivalët e drejtpërdrejtë në Spanjë. Në këto kushte, "telenovela" do të mbyllet vetëm verën e ardhshme.

Herrera dhe Mata rinovojnë kontratat



Huan Mata dhe Ander Herrera do të mbeten pjesë e Mançester Junajtedit. Të dy lojtarët e përfundonin marrëdhënien e tyre me "djajtë e kuq" më 30 qershor 2018, por klubi anglez i ka rinovuar ato edhe për një sezon tjetër, me anë të një klauzole që ata kishin në kontratat e tyre. Ata mund t'i ripërtërinin ato në "Old Trafford" automatikisht dhe në janar, kur skadonte gjysma e vitit

të kontratës. Dhe Mançesteri e ka ekzekutuar këtë opsion. Sipas mediave britanike, Blind dhe Eshli Jang i kanë parë, gjithashtu, kontratat e tyre të zgjerohen edhe nga një sezon. Tani, ekipi i Murinjos mund të negociojë me ta një kontratë me një kohëzgjatje më të gjatë. Por, tani për tani, Ander Herrera dhe Mata do të qëndrojnë në Mançester deri në qershor 2019.

ZBULOHEK KLAUZOLA "BOMBË"

JA SI MESSI MUND TË LARGOHET FALAS NGA BARCELONA

Barcelona mund ta shohë Lionel Messin të largohet nga klubi pa asnjë pagesë, falas, nëse Katalonja është e suksesshme në ofertën e saj për pavarësi, raporton "El Mundo Deportivo"

Kontrata e yllit të Argjentinës ka një klauzolë të shkruar në të, duke treguar se ai mund të largohet falas, nëse Barça nuk do të vazhonte të luante në Spanjë, Angli, Francë apo në garën më të lartë të Gjermanisë. Messi aktualisht ka një klauzolë lirimi prej 700 milionë eurosh në kontratën e tij, e cila u nënshkrua në fund të vitit 2017, por nëse oferta e pavarësisë katalanase do të ishte e suksesshme, 30-vjeçari do të vihej në dispozicion të kujtdo, si një transferim i lirë. Pra, situata politike në Katalonjë ka përfshirë edhe Lionel Messin. Lojtari argjentinës dëshiron të ishte i qartë në lidhje me atë që do të ndodhte në rastin kur Katalonja të fitonte pavarësinë, duke e detyruar Barcelonën për të krijuar kushtet, që të largohet nga klubi.

Messi ka rënë dakord me shk-

rim për rinovimin e kontratës multimilionë eurosh për të vazhduar në Barcelonë, por vetëm në qoftë se pavarësia hipotetike e lejon atë për të luajtur në "një ligë të standarde evropiane", diçka që legjislacioni aktual e bën të pamundur për rastin e spanjollëve. Përndryshe, ai do ta linte automatikisht klubin katalanas, pa pasur nevojë të paguante klauzolën e tij (700 milionë euro). Sulmuesi i Barcelonës ka prezantuar një klauzolë në marrëveshje, sipas të cilës, bie dakord për të luajtur te Barça në rast të shkëputjes (pavarësisë) së Katalonjës, vetëm nëse klubi mbetet pjesë e një prej kompeticioneve më të rëndësishme të kontinentit: ligat angleze, gjermane, franceze, ose spanjolle. Ky opsion i fundit është i papërshtatshëm me Ligjin aktual të Sportit.

Ylli argjentinës ka lëvizur gjatë disa muajve të kaluar në klubin azulgrana përmes përfaqësuesve të tij, duke nënvizuar shqetësimin e tij për gjendjen politike në Katalonjë. Ai ka rinovuar me Barcelonën për katër vitet e ardhshme, ndërkohë që klubi rezervon mundësinë e zgjatjes së marrëveshjes më tej, në të njëjtat kushte. Nëse Katalonja bëhet një republikë e pavarur, por Barcelona vazhdon të luajë në kampionatin spanjoll, ose ka aftësinë për t'u integruar në Bundesligën gjermane, Premier Ligën angleze, Ligue 1 franceze, pesë herë fituesi i "Topit të Artë" mbetet me fanellën Blaugrana. Çdo formulë tjetër që nuk përshtatet në mundësitë e përshkruara, do të shkaktonte largimin e menjëhershëm të Messit, pa pasur nevojë të paguante klauzolën e tij të shlyerjes, 700 milionët stratosferikë.

Siç shpjegohet nga "EL MUNDO", klubi katalanas do të paguajë për Messin një shpërblim bruto prej 100 milionë eurosh, që do të shpërndahet gjatë sezoneve të ardhshme. Kjo shumë e shtuar në kartelë do të dërgojë në 35 milionë euro neto fitim në vit, 70% më shumë se sa merr Cristiano Ronaldo.

Këto shpërblime nuk përfshijnë të drejtat e imazhit, të cilat janë të rezervuara për shfrytëzim të plotë, as bonuset. Vetëm shifrat e rëna dakord nga ish-shoku i tij, Neymar me PSG, janë të afërt me ato që është pajtuar Messi me Barçën.



Sallah, "Lojtari Afrikan i Vitit 2017"

Ylli i kombëtares së Egjiptit dhe Liverpoolit, Mohamed Sallah, është emëruar nga CAF si "Lojtari Afrikan i Vitit 2017".

Sallah e merr çmimin për herë të parë në shtëpi, pasi arriti të mposhte konkurrencën e finalistëve të tjerë, si Sadio Mane dhe Pierr-Emerik Aubamejang, në ceremoninë e shpërblimeve të mbajtur në Accra, Gana. 25-vjeçari mbylli një fushatë mahnitëse për Liverpoolin në vitin 2017. Ai shënoi 23 gola në 29 ndeshje, pasi u bashkua me Premier Ligën nga Roma. Në skenën ndërkombëtare, ai e ndihmoi Egjiptin të renditej në vendin e dytë të Kupës së Kombeve 2017, duke përfshirë golat kundër Ganës dhe Burkina Fasos. Goli i tij kundër Kongos, në tetor, e cila siguroi një fitore 2-1, i ndihmoi "faraonët" të kualifikoheshin për në Kupën e Botës, për herë të parë që nga viti 1990.

Ndryshe, Aubamejang, ndërkohë, shënoi 31 gola të pabesueshëm në 32 paraqitje, në të gjitha garat, "mandatin" e kaluar, por arriti të merrte në duar vetëm "DFB-Pokal" me Borussia Dortmundin. Çmimi i Lojtarit të Vitit të CAF-it fillimisht u përhap në një listë të ngushtë prej 24 të nominuarish. Nga atje, Sallah, Aubamejang dhe Mane u emëruan tre finalistët, në dhjetor. Fituesi i çmimit u përzgjedh nga trajnerët aktualë dhe kapitenët e çdo ekipi kombëtar të meshkujve në Afrikë. Sane përfundoi i dyti në votim, me yllin e Dortmundit, Aubamejang, që u pozicionua në vendin e tretë.



Do ta mbyllë karrierën në Indi!

Pas emrave të njohur si Dimitar Berbatov, Ves Braun dhe Robbi Kin që luajnë prej disa kohësh në ISL, duket se një tjetër "yll" i futbollit botëror mund të vazhdojë karrierën në kampionatin indian të futbollit, duke nisur nga muaji ja-

nar. Ish-sulmuesi i Realit dhe kombëtares së Brazilit, Robinjo, është lënë i lirë nga klubi brazilian i Atletico Mineiro dhe po kërkon një tjetër skuadër. 33-vjeçari ka nisur bisedimet me disa skuadra në Evropë dhe SHBA, por India duket

destinacioni më i mundshëm për të. Robinjo vendosi të largohet nga Mineiro, pasi nuk gjeti gjuhën e përbashkët për rinovimin e kontratës që skadoi pikërisht më 1 janar 2018. ndryshe, Robinjo ka pasur një bisedë me drejtuesit e

Glasgow Renxhers në Skoci, por duket i tunduar nga një ofertë që i ka ardhur nga India. Gjatë karrierës së tij, Robinjo ka luajtur me klube të mëdha si Santos, Real Madrid, Mançester Siti dhe AC Milan.

DUHANI, DISA RREGULLA TË ARTA PËR TA LËNË ATË

Ndalimi i pirjes së duhanit është gjithmonë një qëllim i mirë që shprehet në filim të vitit të ri dhe për ta bërë këtë, ekzistojnë dhjetë 'truke'. Programi i Varësisë nga Duhani në Universitetin Rutgers u publikua në faqen e tyre të internetit. Pothuajse shtatë nga dhjetë duhanpirës, thonë ekspertët amerikanë, do të donin ta ndalonin tërësisht. "Është thelbësore të pyesim veten pse duam ta ndërpresim - thekson Michael Steinberg, drejtor i programit, - hiqni të gjitha produktet e duhanit nga shtëpia dhe nga makina dhe vendosni një datë të saktë ndalimi dhe i qëndroni besnik asaj. Një rregull tjetër themelor është të kërkosht ndihmë, nuk është një sfidë që duhet të tejkalohet me forcë dhe i vetëm". Pasi të merret vendimi është e rëndësishme të ndiqni një mënyrë jetese të saktë, me ushqim adekuat, gjumë të mjaftueshëm dhe aktivitet fizik të rregullt. Është gjithashtu e rëndësishme



të gjeni një metodë për të reduktuar stresin dhe ta kërkonin në rastet kur ju pihet cigare. "Bëni një listë të atyre që shkaktojnë nxitjen për të pirë duhan, - vazhdon eksperti, - dhe përpiqui t'i shmangni këta 'shkaktarë', gjithashtu duke u munduar t'u shmangeni situatave veçanërisht stre-

suese. Është gjithashtu një ide e mirë që të ulni kafeinën, e cila mund t'iu shtojë ankthin dhe mbështetuni në mjetet farmakologjike, si dhe në kërkimin e mbështetjes sociale për vendimin e marrë. Këshilla e fundit, - përfundon ai, - nuk duhet t'iu hiqni kurrë dorë".

13.275 vjet burg për mashtruesin e Tajlandës

Një gjykatë në Tajlandë dënoi për mashtrim një shtetas të saj me më shumë se 130 shekuj burg, me saktë me 13 275 vjet. Pudrit Kittithradilok, 34 vjeç, pranoi se kishte organizuar një skemë piramidale dhe i vidhte paratë njerëzve që gënjejeshin nga përqindjet e larta të fitimit. Më shumë se 40 000 njerëz u mashtruan dhe investuan mbi 160 milionë dollarë në kompanitë e rreme të krijuara prej tij. Gjykatë e shpalli fajtor të paditurin për kredidhënie të jashtëligjshme dhe 2653 akuza mashtrimi. Mbledhja e viteve për çdo akuzë rezultoi në dënimin kolosal. Megjithatë, për shkak se ai rrëfeu dhe pranoi krimet e tij, dënimi u përgjysmua në 6637 vjet burg. Por, ekspertët thonë se nuk pritet që ai të bëjë më shumë se 20 vjet burg, pasi ligji tajlandez vendos një maksimum prej 10 vitesh burg për këto akuza, sado herë që të jenë përsëritur. Mediat në Bangkok shkruajnë se pavarësisht dënimit kolosal që bëri bujë dhe apeleve që pritet të pasojnë, enigma e vetme e çështjes janë milionat që Pudrit mori dhe që janë zhdukur pa lënë gjurmë.



NËNTË TË RINJ NË RREZIK PËR JETËN, NGATËRRUAN KOKAINËN ME "PUDËR"

Ngatërimi i kokainës me pudrën e bardhë ka bërë që nëntë të rinj në Australi të përfundojnë në spital. BBC shkruan se tre prej tyre janë në gjendje të rëndë ndërsa 6 të tjerët janë jashtë rrezikut, por ende qëndrojnë nën kujdesin e mjekëve. Të nëntë vuanin nga paraliza dhe halucinacione kur u paraqitën në spital. Historia e tyre ka nisur me një pako që mbërriti në shtëpinë e tyre gabimisht. Të rinjtë mendonin se brenda gjendej kokainë dhe e ndanë në 9 pjesë midis tyre. Por lënda që ata konsumuan është një lloj pudre, ose drogë që për-

doret në doza të vogla nga kriminelët për grabitje apo sulme seksuale. Nëntë të rinjtë e përdorën atë në doza të mëdha dhe ata mund të rrezikonin të mbeteshin edhe të paralizuar. BBC raporton se të rinjtë u gjetën në shtëpi nga njëri prej shokëve të tyre që ndodhej jashtë për një darkë. Ndërkohë banorët lokalë thanë se i panë të rinjtë të transportoheshin në spital në gjendje të rëndë dhe me sytë e fryrë. "Disa nga këto të rinj do të kishin vdekur nëse nuk do të kishim ndërhyrë", tha njëri nga mjekët për mediat vendase.

PROSTITUTA KTHEHET "NË PUNË" 30 MINUTA PAS LINDJES

Një prostitutë i është rikthyer "profesionit" të saj vetëm 30 minuta, pasi ka sjellë në jetë një fëmijë. Zyrtari për Mbështetjen e Komunitetit tha se ajo ka më shumë se një dekadë që ka punuar si punëtore seksi në një nga rrugët e Londrës. Hessle Road është një rrugë në Hull, Britani ku punojnë më shumë se 40 prostituta dhe shumica janë abuzuar fizikisht dhe seksualisht, dhe shumica prej tyre janë të pastreha dhe flenë rrugëve.



1227 - Ferrand i Portugalisë lirohet nga Luvri.

1453 - Perandori Frederik III shpallet arkidukë i Austrisë.

1497 - Hebrëjtë dëbohen nga Graza e Sirisë.

1535 - Qyteti Lima në Peru themelohet nga Francisko Pizzaro.

1912 - New Mexico shpallet shteti i 47 i SHBA-ve.

1927 - Marina amerikane dërgohet në Nikaragua.

1929 - Aleksandri I themelon diktaturën mbretërore në Jugosllavi.

1929 - Nëna Terezë arrin në Kalkutë për të filluar punën në mesin e të varfërve dhe të sëmurëve indian.

1950 - Britania njeherë Qeverinë komuniste të Kinës.

1972 - Vlladimir Bukovski largohet nga BRSS.

1980 - Partia e Kongresit të Indira Gandit fiton zgjedhjet në Indi.

Në Armeni, loja e shahut është një lëndë shkollore që u mësohet fëmijëve që në moshën 6-vjeç dhe është lëndë e detyrueshme.



Çaikovski vuante nga depresioni dhe ishte një hipokondriak i njohur. Ai mendonte se koka do i binte në tokë ndërsa dirigjonte. Madje, mbante kokën lart me një rëndë, ndërkohë që ndodhej para orkestrës.



Sipas një studimi njerëzimit nuk sëmuren për shkak të motit të ftohtë. Ata sëmuren për shkak se në këtë periudhë qëndrojnë në ambiente të mbyllura.



ORA 3 E NATËS

Djali merr të dashurën në telefon!
Djali: Zemër ku je?
Vajza: Në shtrat jam, shumë e lodhur dhe po mendoj për ty ...po ti?
Djali: Unë jam në party ...një tavolinë pas teje!



Më quajnë presidenti më i varfër në botë, por unë nuk ndihem i tillë... të varfër janë ata që punojnë për tu bërë të pasur, duke harruar kuptimin e vërtetë të fjalës "pasuri"!

(Jose Mujica, ish-presidenti i Uruguait)



KALENDARI HISTORIK 6 JANAR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS